



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government

Ministria e Mbrojtjes së Kosovës
Ministarstvo Odbrane / Ministry of Defense

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO			
MINISTRIA E MBROJTJES / MINISTARSTVO ODBRANE / MINISTRY OF DEFENSE			
Nr. Prot:	2705	Nr. i f. qeverie	71
Br. Prot:		Br. Stranica	
No. Prot:		No. of pages	
Data:	30	/ 07 / 20	19
Datum:			
Prishtinë / a			

PLANI AFATMESËM I MM/FSK (2019-2023)

 Z. Rustem Berisha
Ministër i Ministrisë së Mbrojtjes



Përmbajtja:

Referencat.....	7
Akronimet.....	7
I. Hyrje.....	9
II. Qëllimi.....	9
III. Objektivat strategjike afatmesëm 2019-2023.....	10
IV. Aftësitë që synohet të zhvillohen dhe arrihen gjatë periudhës 2019-2023	11
V. Prioritetet kryesore në funksion të realizimit të objektivave.....	16
VITI 2019	
MINISTRIA E MBROJTJES	16
1.1. Procesi i hartimit të akteve ligjore dhe nënligjore.....	16
1.2. Procesi i tranzicionit të MFSK/KFT-së në MM/SHPFSK.....	16
1.3. Miratimi i draft-dokumenteve kryesore strategjike.....	17
1.4. Miratimi i draft-dokumenteve kryesore planifikuese	17
1.5. Fillimi i procesit të zhvillimit të politikave të mbrojtjes	17
1.6. Koordinimi ndërministror dhe ndërinstitutional për menaxhimin e krizave	17
1.7. Vazhdimi i bashkëpunimit ndërkombëtar me synim anëtarësimin në iniciativat rajonale dhe integrimin në NATO.....	18
1.8. Zgjerimi i bashkëpunimit dypalësh me Forcat e Armatosura të SHBA, vendeve të rajonit NATO-s dhe BE-s.....	18
1.9. Pjesëmarrja aktive dhe kontributi substancial i FSK-së në ushtrimet, organizatat, iniciativat rajonale si dhe në ndërtimin e stabilitetit dhe bashkëpunimit rajonal	19
1.10. Riorganizimi i personelit sipas strukturës organizative të MM/SHPFSK dhe avancimi i sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore.....	19
1.11. Avancimi i sistemit të inteligjencës ushtarake dhe sigurisë.....	20
1.12. Zhvillimi i sistemit të arsimit ushtarak	20
1.13. Zhvillimi i sistemit të mbështetjes logjistike dhe infrastrukture.....	21
1.14. Zhvillimi i sistemit të komunikimit dhe informatikës.....	22

2.SHTABI I PËRGJITHSHËM I FSK-së.....	22
2.1.Tranzicionii KDS/BMO në KDS/KL.....	22
2.2.Zhvillimi i kuadrit doktrinar dhe planifikues në nivelin operacional dhe taktik.....	22
2.3.Mirëmbajtja e aftësive ekzistuese operacionale	23
2.4.Mirëmbajtja e gatishmërisë operacionale	24
2.5.Krijimi i elementeve të mbështetjes qendrore logjistike.....	24
2.6.Zhvillimi dhe avancimi i kapaciteteve të komandimit, kontrollit dhe komunikimit.....	25
2.7.Bashkëpunimi civilo-ushtarak.....	25
KOMANDA E FORCAVE TOKËSORE.....	26
2.8.Mirëmbajtja e kapaciteteve dhe aftësive të reagimit të shpejtë.....	26
KOMANDA E DOKTRINËS DHE STËRVITJËES - KDS.....	26
2.9.Fillimi i zhvillimit të programeve të reja të trajnimit dhe stërvitjes	26
KOMANDA E LOGJISTIKËS.....	27
2.10. Mbështetja logjistike e njësive gjatë procesit të mirëmbajtjes së aftësive ekzistuese dhe procesit të tranzicionit.....	27
VITI 2020	
OBJEKTIVAT DHE AFTËSITË KRYESORE VJETORE TË SYNUARA.....	31
MINISTRIA E MBROJTJES	31
1.1.Vazhdimi i hartimit të akteve të reja ligjore dhe nënligjore për MM/FSK.....	31
1.2.Zhvillimi i sistemit të integruar të planifikimit të mbrojtjes.....	31
1.3. Digjitalizimi i bazës së të dhënave të personelit.....	31
1.4.Pjesëmarrja ndërkombëtare në ushtrime, organizata dhe iniciativa rajonale.....	32
1.5.Pjesëmarrja në partneritet e Republikës së Kosovës me NATO / BE-n.....	32
2.SHTABI I PËRGJITHSHËM I FSK-së	33

2.1.Mirëmbajtja e kapaciteteve dhe aftësive operacionale për MUAC.....	33
2.2.Sistemi i inteligjencës ushtarake i nivelit operativ dhe taktik	34
KOMANDA E DOKTRINËS DHE STËRVITJES	34
2.3.Procesi i trajnimit për personelin e MM/FSK-së	34
KOMANDA E LOGJISTIKËS-KL.....	36
2.4.Vazhdimi i shtimit të kapaciteteve dhe aftësive të mbështetjes logjistike.....	36
2.5. Rezervat ushtarake.....	36
KOMANDA E FORCAVE TOKËSORE-KFT.....	36
2.6.Tranzicioni BRSH-së në KFT dhe BATIRSH në REG1 të Këmbëtorisë.....	36
VITI 2021	
1.MINISTRIA E MBROJTJES	38
1.1.Procesi përfundimtar i hartimit të akteve ligjore dhe nënligjore	38
1.2.Procesi përfundimtar i hartimit të dokumenteve doktrinarë, udhëzuese e procedurale.....	38
1.3.Vazhdimi i procesit të rekrutimit	38
1.4. Ndërtimi i objekteve të reja akomoduese dhe poligoneve për trajnime taktike.....	38
1.5.Vazhdimi i procesit integruar në mekanizmat ndërkombëtarë të sigurisë	39
1.6.Vazhdimi i realizimit të projekteve infrastrukturore dhe blerjes së pajisjeve	39
2.SHTABI I PËRGJITHSHËM I FSK-së.....	39
2.1.Vazhdimi i mirëmbajtjes së kapaciteteve dhe aftësive operacionale për MUAC.....	39
KOMANDA E FORCAVE TOKËSORE-KFT.....	39
2.2.Tranzicioni i BAT2RSH në REG2 të Këmbëtorisë.....	39
KOMANDA E DOKTRINËS DHE STËRVITJES.....	39
2.3.Vazhdimi i ngritjes së kapaciteteve trajnuese për këmbësori.....	39
KOMANDA E LOGJISTIKËS - KL.....	40

2.4.Ndërtimi i objekteve të reja për akomodim dhe poligoneve taktike	40
2.5.Ngritja, zhvillimi dhe funksionalizimi i Poliklinikës Mjekësore	40
VI. Planifikimi i buxhetit të mbrojtjes për periudhën afatmesme 2019-2023	40
VITI 2022	
OBJEKTIVAT DHE AFTËSITË KRYESORE VJETORE TË SYNUARA.....	41
MINISTRIA E MBROJTJES	41
1.1. Rishikimi dhe hartimi sipas nevojës së akteve ligjore dhe nënligjore.....	41
1.2. Vazhdimi i procesit të hartimit dhe rishikimit të vazhdueshëm me qëllim përditësimin e dokumenteve doktrinarë, udhëzuese dhe procedurale.....	41
1.3. Vazhdimi i procesit të rekrutimit.....	41
1.4. Ndërtimi i objekteve të reja për akomodim dhe poligoneve për trajnime taktike.....	41
1.5. Vazhdimi i procesit integruar në mekanizmat ndërkombëtarë të mbrojtjes dhe sigurisë.....	42
1.6. Vazhdimi i realizimit të projekteve infrastrukturore si dhe blerjeve të sistemeve dhe pajisjeve individuale dhe kolektive sipas FOCIS.....	42
2.SHTABI I PËRGJITHSHËM I FSK-së	42
2.1. Mirëmbajtja e kapaciteteve, aftësive dhe gatishmërisë së plotë operacionale për MUAC.....	42
KOMANDA E FORCAVE TOKËSORE	42
2.2. Tranzicioni i BAT-3 RSH-së në REGJ-3 të Këmbëorisë.....	42
KOMANDA E DOKTRINËS DHE STËRVITJES-KDS.....	43
2.3. Vazhdimi i ngritjes së kapaciteteve trajnuese për këmbëtori.....	43
KOMANDA E LOGJISTIKËS-KL.....	43
2.4.Vazhdimi i shtimit të kapaciteteve dhe aftësive të mbështetjes logjistike.....	43
VIII OBJEKTIVAT DHE AFTËSITË KRYESORE TË SYNUARA PËR VITIN 2023.....	43
MINISTRIA E MBROJTJES	43

1.1. Rishikimi dhe hartimi sipas nevojës i akteve ligjore dhe nënligjore.....	43
1.2. Vazhdimi i procesit të hartimit dhe rishikimit të vazhdueshëm me qëllim përditësimin e dokumenteve strategjike, doktrinarë dhe procedurale.....	44
1.3. Vazhdimi i procesit të rekrutimit.....	44
1.4. Ndërtimi i objekteve të reja për akomodim dhe poligoneve për trajnime taktike	44
1.5. Vazhdimi i procesit integruar në mekanizmat ndërkombëtarë të mbrojtjes dhe sigurisë.....	44
1.6. Vazhdimi i realizimit të projekteve infrastrukturore si dhe blerjeve të sistemeve dhe pajisjeve individuale dhe kolektive sipas FOCIS.....	44
SHTABI I PËRGJITHSHËM I FORCËS SË SIGURISË TË KOSOVËS	44
2.1. Mirëmbajtja e kapaciteteve, aftësive dhe gatishmërisë së plotë operacionale për MUAC.....	44
KOMANDA E FORCAVE TOKËSORE.....	45
2.2. Vazhdimi i tranzicionit të BAT-3RSH-së në REGJ-3 të Këmbëtorisë.....	45
KOMANDA E DOKTRINËS DHE STËRVITJES-KDS.....	45
2.3. Vazhdimi i ngritjes së kapaciteteve trajnuese për këmbësori.....	45
KOMANDA E LOGJISTIKËS-KL.....	45
2.4. Vazhdimi i shtimit të kapaciteteve dhe aftësive të mbështetjes logjistike.....	45
IX. PËRMBLEDHJE.....	46

SHTOJCAT:

Shtojca A: Plani i hartimit të akteve ligjore dhe nënligjore (2019-2023)

Shtojca B: Plani i hartimit të dokumenteve strategjike dhe doktrinare(2019-2023)

Shtojca C: Plani i rekrutimit të personelit të MM/FSK-së dhe njësive të saj (2019-2023)

Shtojca D: Plani i arsimimit ushtarak për personelin e FSK-së (2019-2023)

Shtojca E: Plani i trajnimit për personelin e FSK-së (2019-2023)

Shtojca F: Plani i realizimit të projekteve të infrastrukturës dhe blerjeve (2019-2023)

Referencat:

- Analiza e Rishikimit Strategjik të Sektorit të Sigurisë (2014)
- Plani Gjithëpërfshirës i Tranzicionit (2019-2028)
- Plani Afatgjatë i Zhvillimit të FSK-së (A+10)
- Korniza Afatmesme e Shpenzimeve (2019-2021)
- Moduli i FOCIS-it

Akronimet

1. FSK.....	Forca e Sigurisë së Kosovës
2. NATO.....	North Atlantic Treaty Organization(Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior)
3. RSSS.....	Rishikimi Strategjik i Sektorit të Sigurisë
4. RKS.....	Republika e Kosovës
5. MM.....	Ministria e Mbrojtjes
6. SHPFSK.....	Shtabi i Përgjithshëm i Forcës së Sigurisë të Kosovës
7. FT.....	Forca Tokësore
8. KL.....	Komanda e Logjistikës
9. GK.....	Garda Kombëtare
10. C2.....	Komandë dhe Kontroll
11. C3.....	Komandë-Kontroll-Komunikim
12. BE.....	Bashkësia Evropiane
13. OKB.....	Organizata e Kombeve të Bashkuara
14. PPBES.....	Planning, Programming, and Budgeting Executing System(Sistemi i Planifikimit, Programimit, Buxhetimit dhe Ekzekutimit)
15. MUAC.....	Mbështetja Ushtarake Autoriteteve Civile
16. KASH.....	Korniza Afatmesme e Shpenzimeve
17. SKI.....	Sistemi i Komunikimit dhe Informatikës
18. BCU.....	Bashkëpunimi Civilo-Ushtarak
19. KFO.....	Kapacitetet Fillestare Operacionale
20. KPO.....	Kapacitetet e Plota Operacionale
21. OSBE.....	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
22. MFSK.....	Ministria e Forcës së Sigurisë të Kosovës
23. PAZH.....	Plani Afatgjatë Zhvillimor
24. PAM.....	Plani Afatmesëm
25. CPG.....	Comprehensive Political Guidance(Udhëzimet Politike Gjithëpërfshirëse)
26. SHBA.....	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
27. KDS.....	Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes
28. DKTI.....	Departamenti i Komunikimit, Teknologjisë dhe Informatikës
29. COMSEC.....	Communication Security(Siguria e Komunikimit)
30. INFOSEC.....	Information Security(Siguria e Informacionit)
31. KFT.....	Komanda e Forcave Tokësore
32. OJQ.....	Organizatat Joqeveritare

33. ODC	Office of Defense Cooperation (Zyra për Bashkëpunim e Mbrojtjes)
34. EUCOM	European Command /USEUCOM(Komanda për Evropë)
35. A5	Adriatic Charter(Karta e Adriatikut)
36. PfP	The Partnership for Peace Programme(Programi i Partneritetit për Paqe)
37. KASH	Korniza Afatmesme e Shpenzimeve
38. FOCIS	Force Oriented Cost Information System
39. TOPP	Tabela e Organizimit e Personelit dhe Pajisjeve
40. TOP	Tabela e Organizimit të Pajisjeve
41. PSO	Procedura Standarde Operative
42. NALT	Ekipi Këshillues i NATO-s
43. MKAB	Mbrojtja Kimike Atomike dhe Biologjike
44. BMO	Brigada e Mbështetjes Operacionale
45. BRSH	Brigada e Reagimit të Shpejtë
46. NJNRK	Njësia Ndërlidhëse e Reagimit në Kriza
47. KK	Kompania e Komunikimit
48. KM	Kompania e Mjekësisë
49. PF	Policia e Forcës
50. QSU	Qendra e Studimeve Universitare
51. C4	Komandë-Kontroll-Komunikim-Kompjuterizim
52. C4I	Komandë-Kontrollë-Komunikim-Kompjuterizim dhe Inteligjencë
53. FT	Forca Tokësore
54. GK	Garda e Kosovës
55. RMC	Regjimenti i Mbrojtjes Civile
56. KL	Komanda e Logjistikës
57. PKT	Post Komanda Taktike
58. LEDZM	Lista Esenciale e Detyrave për Zbatimin e Misionit
59. MIT	Mbrojtja e Integritetit Territorial
60. ON	Operacionet Ndërkombëtare
61. SUT	Specialised Units Training
62. ZKM	Zyra e Kryeministrit
63. MSH	Ministria e Shëndetësisë
64. MPJ	Ministria e Punëve të Jashtme
65. MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
66. MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
67. MI	Ministria e Infrastrukturës
68. AME	Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave
69. PK	Policia e Kosovës

I. Hyrje

Në përputhje të plotë me Analizën e RSSS-së, Ministria e FSK-së dhe FSK-ja, në kuadër të rolit dhe përgjegjësisë në këtë proces, kanë zhvilluar procesin e planifikimit afatgjatë (PGJT dhe PAZH) për implementimin e rekomandimeve përkatëse, respektivisht procesin e tranzicionit të MFSK-së në Ministri të Mbrojtjes (MM) dhe të FSK-së në Ushtri (ngritjen e kapaciteteve e aftësive të reja për përmbushjen e misionit të ri legjislativ/kushtetues të saj).

Plani Afatmesëm pesëvjeçarë 2019-2023 është dokument orientues, përgjegjës dhe zbatues të të cilit janë MM dhe FSK me njësitë kryesore të tyre SHPFSK, KDS, KL, GK dhe KFT, të cilët bashkërendojnë detyrat dhe aktivitetet për realizimin e objektivave dhe prioritetëve për periudhën kohore planifikuese 2019-2023. Për një planifikim të mirë, efektiv dhe të zbatueshëm janë angazhuar të gjithë faktorët relevantë brenda MM/FSK-së, të cilët nga pozicioni i fushëveprimit të tyre sektorialë kontribuuan në hartimin e PAM-it të duhur. Në vazhden e parapërgatitjeve për fillimin e procesit të tranzicionit të MFSK/FSK-së në MM/FSK, Komisioni për Implementimin e Rekomandimeve të RSSS-së pas vendimit për hartimin e draftit të PAZH-it, ka proceduar edhe hartimin e draftit të PAM-it për periudhën pasuese pesëvjeçare pas ndryshimeve legjislative, pra periudhën pas vendimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës për tranzicionin deri në përfundim të fazës së parë të procesit të tranzicionit, pra vitit të tretë të tij dhe plus për dy vite shtesë të fazës së dytë të PGJT-së me drejtime dhe përkufizime kryesore për arritjen e kapaciteteve fillestare me mision të ri, të referuar në dokumentet strategjike planifikuese PGJT dhe PAZH. Një sistem i tillë i organizimit të planifikimit me përfshirje të gjerë të kuadrit ministror të MM-së dhe të FSK-së në zhvillimin e PAM-it, mundësoi vendosjen e saktë dhe të qartë të qëllimeve, përcaktimin e veprimeve për arritjen e qëllimeve dhe mobilizimin e burimeve për t' i ekzekutuar veprimet në periudhën më të rëndësishme nëpër të cilën po kalon aktualisht MM/FSK në implementimin e procesit të tranzicionit.

II. Qëllimi

Qëllimi i Planit Afatmesëm (PAM) 2019-2023 është organizimi i veprimit të MM-së dhe FSK-së në mënyrë koherente për realizimin e objektivave të përcaktuar, mënyrës së matjes së rezultateve në procesin e tranzicionit, ngritjes së Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të FSK-së me njësitë për periudhën kohore përkatëse me misionin e ri, si dhe zhvillimin e përgjithshëm të tyre. Gjithashtu përmes këtij plani, konkretizohen aktivitetet të cilat do të ndërmerren për realizimin e qëllimeve të planifikuara për të arritur rezultatet e synuara. Objektivat kryesore që synohen të realizohen (arrihen) gjatë periudhës afatmesme pesëvjeçare (2019-2023) janë: Implementimi dhe zhvillimi i Planit Gjithëpërfshirës të Tranzicionit dhe planeve të tjera mbështetëse, më qëllim ngritjen e njësive dhe arritjen e aftësive operacionale të FSK-së, sipas kursit të veprimit të përcaktuar në PGJT; Arritja e kapaciteteve dhe aftësive të plota funksionale të të gjitha komponentëve të strukturës organizative të MM-së dhe SHPFSK-së; kompletimi i pakos së akteve kryesore ligjore dhe nënligjore si dhe dokumenteve kryesore strategjike dhe planifikuese; zhvillimi i politikave për menaxhimin e burimeve të trashëguara dhe atyre të reja njerëzore, materiale, infrastrukturore, pasurisë së patundshme dhe burimeve financiare të mbrojtjes; konsolidimi dhe zhvillimi i mëtejme i kapaciteteve të mbështetjes operacionale; zhvillimi i politikave të reja për koordinimin ndërministror dhe ndërinstitutional vendor; vazhdimi i fuqizimit të politikave në funksion të bashkëpunimit dypalësh dhe shumëpalësh, si dhe politikave të integritetit në mekanizmat rajonale dhe ndërkombëtare të sigurisë dhe mbrojtjes me synim të përhershëm anëtarësimi në NATO-n

dhe strukturat e saj; zbatimi i detyrimeve që rrjedhin nga marrëveshjet e bashkëpunimit dypalësh dhe shumëpalësh me forcat partnere për pjesëmarrje në operacione ushtarake ndërkombëtare dhe ndërvepruese me NATO-n, si dhe për pjesëmarrje në stërvitje të përbashkëta; Mbajtja në kontinuitet të aftësive ekzistuese operacionale për MUAC dhe koordinimin e aktiviteteve nga fushëveprimi i bashkëpunimit civilo-ushtarak; si dhe krijimi i kapaciteteve të para të plan-programeve, personelit, infrastrukturës, mbështetjes logjistike, arsimimit, trajnimeve dhe stërvitjeve në funksion të misionit të ri të mbrojtjes së territorit. Përmes PAM-it, gjithashtu do të mund të sigurojmë informacionin e saktë dhe të qartë për trendin e progresit nga fillimi i zbatimit të planifikimit deri në fund të këtij procesi. Ky plan do të mundësojë sigurimin e koordinimit në mes të përgjegjësve në të gjitha nivelet dhe hallkat e zingjirit hierarkik dhe strukturës organizative të Ministrisë së Mbrojtjes, Shtabit të Përgjithshëm të Forcës së Sigurisë të Kosovës dhe komandave e shtabeve të njësive të saj. PAM-i do t'i mundësojë lidhshirë të MM-së dhe FSK-së që të kenë pasqyrë të qartë të zhvillimit të procesit të realizimit të synimeve të tyre, respektivisht objektiva të përcaktuara strategjike dhe aftësitë që synohen të arrihen për çdo vit brenda periudhës afatmesme. Gjithashtu ky plan u mundëson monitorimin dhe kontrollin e tij në të gjitha fazat e zhvillimit, kurse bartësve për implementimin e tij u ofron informacionin e qartë për synimet e lidhshirë të MM-së dhe FSK-së. Nga ky fakt, zhvillimi i aktiviteteve do të ketë rrjedhën dhe ndërlidhshmërinë e natyrshme në kuadër të procesit të implementimit të tij në nivel strategjik, operativ dhe taktik me tregues të matshëm dhe të saktë. Gjithashtu, ky plan ka për qëllim të përkufizojë, të pasqyrojë, të adresojë dhe të parashtrijë, drejtimin themelor të MM/FSK për periudhën kohore pesëvjeçare dhe të shërbejë njëkohësisht si orientues konkret në procesin e zhvillimit strukturor, organizativ, menaxhues, njerëzor, material, financiar dhe operacional të MM-së dhe FSK-së. PAM-i përkatës do të mundësojë edhe orientimin dhe bashkërendimin e angazhimeve të MM/FSK në përputhje me Planin Gjithëpërfshirës të Tranzicionit (2019-2028), PAZH-in (A+10), Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve (2019-2021 dhe 2020-2022), mjedisin e sigurisë dhe kapacitetet operacionale gjatë periudhës së përcaktuar dhe të planifikuar trevjeçare dhe orientuese dyvjeçare.

III. Objektivat Strategjikë 2019-2023

Bazuar në Analizën e RSSS-së, të PGJT-së (2019-2028), të PAZH-it (A+10), si dhe në politikat e MM-së/FSK-së për procesin e implementimit të planeve përkatëse, janë përcaktuar objektivat strategjikë të MFSK/FSK-MM/FSK për periudhën afatmesme (2019-2023) si në vijim:

1. Hartimi, finalizimi dhe aprovimi i dokumenteve strategjike dhe akteve nënligjore të nevojshme për funksionim të Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së;
2. Implementimi i Planit Gjithëpërfshirës të Tranzicionit dhe planeve tjera mbështetëse me qëllim ngritjen e njësive dhe arritjen e aftësive operacionale të FSK-së sipas kursit të veprimit të përcaktuar në PGJT;
3. Avancimi dhe zhvillimi i sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore, materiale, infrastrukturë, financiare, si dhe vazhdimi i avancimit të standardeve të transparencës, llogaridhënies, integritetit, besueshmërisë dhe imazhit institucional;
4. Avancimi i sistemit të inteligjencës dhe sigurisë;
5. Ngritja e programeve të reja arsimore dhe trajnuese për misionin e ri dhe mirëmbajtja e aftësive ekzistuese operacionale;
6. Mbështetja logjistike dhe infrastrukturë për punë, jetë dhe mësim;

7. Avancimi i sistemit të mbështetjes mjekësore;
8. Avancimi i sistemit të komandës, kontrollit dhe komunikimit (C3);
9. Avancimi i bashkëpunimit civilo-ushtarak dhe mbështetja ushtarake autoriteteve civile të vendit;
10. Thellimi dhe zgjerimi i bashkëpunimit ndërkombëtar me synim anëtarësimin në iniciativat rajonale dhe integrimin në NATO.

IV. AFTËSITË E PËRGJITHSHME QË SYNOHEN TË ZHVILLOHEN DHE ARRIHEN GJATË PERIUDHËS AFATMESME (2019-2023)

Ministria e Mbrojtjes

- Arritja e kapaciteteve dhe aftësive të plota funksionale të të gjitha komponentëve të strukturës organizative ministrore;
- Vendosja e kapaciteteve të plota të administrimit dhe menaxhimit të kontrolleve të brendshme mbi strukturën funksionale të MM-së;
- Ushtrim i plotë i mbikëqyrjes dhe kontrollit civil dhe demokratik mbi FSK-në;
- Zhvillimi i politikave për menaxhimin e burimeve të trashëguara dhe atyre të reja njerëzore, materiale, infrastrukture, pasurisë së patundshme dhe burimeve financiare të mbrojtjes;
- Konsolidimi dhe zhvillimi i mëtejshëm kapaciteteve të inteligjencës, sigurisë, sistemit të komunikimit dhe mbrojtjes kibernetike;
- Zhvillimi i politikave të reja për koordinimin ndërministror (me MPB-në) me qëllim të fuqizimit të sistemit për menaxhimin e krizave me mekanizmat tjerë të sigurisë shtetërore (AME-në)
- Vazhdimi i fuqizimit të politikave në funksion të bashkëpunimit dypalësh dhe shumëpalësh si dhe politikave të integritetit në mekanizmat rajonale dhe ndërkombëtare të sigurisë dhe mbrojtjes me synim të përhershëm NATO-në dhe strukturat e saj (PfP, A5 etj.).

Shtabi i Përgjithshëm i FSK-së

- Tranzicioni dhe arritja e kapaciteteve dhe aftësive të plota funksionale të të gjithë komponentëve të strukturës organizative të shtabit (nga G1 deri në G9) dhe elementet mbështetëse;
- Tranzicioni dhe arritja e kapaciteteve dhe aftësive të plota funksionale të të gjitha njësive pranshtabore të shtabit (komunikimit, policisë ushtarake, mbështetjes) dhe Kompanisë për Operacione me Civilët (KOC);
- Akademisë Ushtarake (AU);
- Riorganizimi në bazë të strukturës si dhe funksionalizimi i plotë i sistemit të komandimit, kontrollit dhe komunikimit (C3) të njësive vartëse;
- Zhvillimi i plan-programeve të reja për fushat funksionale shtabore (personelit, inteligjencës, operacioneve, logjistikës, planifikimit, komunikimit, bashkëpunimit civilo-ushtarak, në mbështetje të komandave dhe shtabeve të njësive dhe nën-njësive vartëse (KDS, KL dhe KFT);
- Varësia e drejtpërdrejt nga SHPFSK e Regjimentit të Mbrojtjes Civile dhe Batalionit të Xhenios, në funksion të mbajtjes në kontinuitet të aftësive ekzistuese operacionale për MUAC;

- Ngritja e aftësive dhe kapaciteteve për koordinimin e aktiviteteve nga fushëveprimi i bashkëpunimit civilo-ushtarak;
- Zbatimi i detyrimeve që dalin nga Strategjia e Mbrojtjes dhe politikat tjera të Ministrisë së Mbrojtjes për të gjitha komponentët e FSK-së;
- Udhëheqja operationale e procesit të tranzicionit të njërive vartëse sipas planit të tranzicionit për fazën e parë (2019-2021);
- Zbatimi i detyrimeve që rrjedhin nga marrëveshjet e bashkëpunimit dypalëshe dhe shumëpalëshe me forcat partnere për pjesëmarrje në operatione ushtarake ndërkombëtare dhe ndërvepruese me NATO-n si dhe për pjesëmarrje në stërvitje të përbashkëta;
- Hartimi dhe miratimi i doktrineve funksionale sipas prioriteteve.

Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes

- Tranzicioni dhe arritja e kapaciteteve dhe aftësive të plota funksionale të të gjithë komponentëve të strukturës organizative komanduese dhe shtabore të KDS-së;
- Arritja e kapaciteteve dhe aftësive të plota funksionale të të gjitha qendrave doktrinare dhe trajnuese dhe njërive të tjera të strukturës organizative të KDS-së;
- Zhvillimi i doktrineve në funksion të zhvillimit të aftësive për mbrojtjen e territorit dhe standardizimi i dokumentacionin zyrtar ushtarak;
- Përgatitja e botimeve dhe publikimeve zyrtare dhe të veçanta ushtarake;
- Mbajtja e kapaciteteve doktrinare dhe trajnuese në funksion të mirëmbajtjes së aftësive operationale të trashëguara nga FSK-ja;
- Krijimi i kapaciteteve të para të instruktorëve për trajnime bazike dhe specialistike si dhe realizimi i programeve stërvitore bazike dhe specialistike për rekrutë aktivë dhe rezervë;
- Krijimi i kapaciteteve të para të trajnuara dhe stërvitjes së nënoficerëve, oficerëve aktivë dhe rezervë për mbështetje efikase të FSK-së në operationet ushtarake dhe jo-ushtarake;
- Realizimi i programeve mbështetëse stërvitore dhe ushtrimeve për njësitë në nivelin e togut dhe të kompanisë;
- Rekrutimi, zhvillimi dhe diplomimi i katër gjeneratave të para të udhëheqësve ushtarakë të rinj të FSK-së në Akademinë Ushtarake;
- Hartimi i plan-programeve (kurrikulave) dhe moduleve standarde për këmbësori, mbështetje luftarake dhe mbështetje luftarake me shërbime për fushë-misionin e mbrojtjes territoriale;
- Krijimi i plan-programit arsimor ushtarak dhe zhvillimi i procesit të akreditimit të Akademisë Ushtarake krahas institucioneve të arsimit të lartë në vend;
- Krijimi i kuadrove të para profesionale me përgatitjen, trajnimin dhe kualifikimin e personelit të FSK-së me trajnimet specialistike të pjesëtarëve për dy regjimentet e këmbësorisë.

Komanda e Logjistikës

- Arritja e kapaciteteve dhe aftësive të plota funksionale të të gjithë komponentëve të strukturës organizative komanduese dhe shtabore të KL-së;
- Arritja e kapaciteteve dhe aftësive të plota funksionale të të gjitha njërive të strukturës organizative të KL-së për mbështetje dhe qëndrueshmëri në mirëmbajtje, furnizim dhe transport, me qëllim të përmbushjes së misionit të FSK-së që nënkupton:
 - Kapacitetet dhe aftësitë e plota për pranimin, ruajtjen, regjistrimin dhe shpërndarjen e të gjitha llojeve materiale dhe teknike për FSK-në;

- Kapacitetet dhe aftësitë e plota për riparimin dhe mirëmbajtjen e të gjitha sistemeve të automjeteve, armatimit dhe pajisjeve të FSK-së që nënkupton nivelin II në kazermat e njësisve dhe nivelet III dhe IV në Njësinë Qendrore të Mirëmbajtjes;
- Kapacitetet dhe aftësitë e plota të transportit në përkrahje dhe mbështetje të njësisve të FSK-së në operacione dhe asistencë në transport për autoritetet tjera civile;
- Kapacitetet e para të rezervave dhe stokeve luftarake dhe jo-luftarake; dhe
- Kapacitetet mjekësore për përkrahje dhe mbështetje në të gjitha nivelet e forcave, në operacione luftarake, në rast nevojë ofron mbështetje për autoritetet civile (ROL1 dhe ROL2), si dhe funksionalizimi i Poliklinikës Mjekësore.

Komanda e Forcave Tokësore

- Tranzicioni dhe arritja e kapaciteteve dhe aftësive të plota funksionale të të gjithë komponentëve të strukturës organizative komanduese dhe shtabore të KFT-së;
- Mirëmbajtja në nivelin e duhur të kapaciteteve ekzistuese operacionale për Mbështetje Ushtarake të Autoriteteve Civile (MUAC) për autoritetet lokale në zonat rajonale të përgjegjësisë;
- Arritja e kapaciteteve të para operacionale të Regjimentit-I-rë të Këmbësisë me dy kompanitë e këmbësisë dhe vazhdimi i zhvillimit të kapaciteteve të Kompanisë së motorizuar të Regjimentit të Parë. Zhvillimi në proces i tranzicionit të Batalionit-II-të të RSH(Reagimit të Shpejt)-së në Regjimentin-II-të të Këmbësisë;
- Përpilimi dhe zyrtarizimi i Listës së Detyrave Esenciale për Zbatimin e Misionit (LDEZM) për KFT-në, regjimentet dhe kompanitë;
- Përpilimi i Procedurave Standarde Operative (PSO) për detyrat taktike të njësisve të KFT-së.

Zhvillimi i aftësive* të synuara më lart për periudhën pesëvjeçare 2019-2023 do të maten mbi bazën e kriterëve matëse dhe objektivave të përcaktuar. Kriteret matëse do të jenë të bazuara në këto fusha:

Doktrina: Shkalla e përmbushjes së kuadrit doktrinar kryesor dhe kuadrove funksionale nëpër vite sipas Shtojcës B.	D
Organizimi: Shkalla e përmbushjes së operacionalitetit të komandave dhe shtabeve sipas Planit Gjithëpërfshirës të Tranzicionit–për periudhën pesëvjeçare (2019-2023).	O
Trajnimi: Shkalla e përmbushjes së pakos së trajnimeve bazë individuale, trajnime të avancuara individuale dhe specialistike, si dhe stërvitjeve kolektive për njësi.	T
Materiali: Shkalla e përmbushjes së planit të prokurimit/blerjeve të pajisjeve, automjeteve, sistemeve të armatimit, komunikimit etj.	M
Udhëheqja dhe Edukimi: Shkalla e përgatitjes së kuadrit udhëheqës nga niveli i skuadrës deri te liderët e lartë (gradës gjeneral) në përputhje me ciklin e zhvillimit profesional.	L
Personeli: Shkalla e përmbushjes së kapaciteteve të personelit të kualifikuar për përmbushjen e detyrave të misioneve (MUAC dhe kapaciteteve të para të OMP dhe MT-së).	P
Objektet/Infrastruktura: Shkalla e përmbushjes së planit të projekteve infrastrukturore, instalimeve dhe poligoneve taktike, objekteve të akomodimit etj.	F

**Termi “Zhvillimi i aftësive” përfshin identifikimin, vlerësimin dhe dokumentimin (raportimin) e progresit në doktrina, organizim, trajnime, materiale, udhëheqje dhe edukim, personel dhe objekte (DOTMLPF).*

V. OBJEKTIVAT DHE AFTËSITË KRYESORE VJETORE TË SYNUARA PËR VITIN 2019

OBJEKTIVAT VJETORE PËR VITIN 2019

1. Hartimi, finalizimi dhe aprovimi i dokumenteve strategjike dhe akteve nënligjore të nevojshme për funksionim të Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së;
2. Implementimi i Planit Gjithëpërfshirës të Tranzicionit (2019-2028) dhe planeve të tjera mbështetëse me qëllim ngritjen e njësive dhe arritjen e aftësive operacionale të FSK-së sipas kursit të veprimit të përcaktuar në PGJT;
3. Zgjerimi dhe avancimi i bashkëpunimit dypalësh me Forcat e Armatosura të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, vendeve të rajonit, NATO-s dhe BE-s me synim anëtarësimin në iniciativat rajonale dhe integrimin në NATO;
4. Mbajtja e vazhdueshme e aftësive ekzistuese operacionale për mbështetjen ushtarake të autoriteteve civile dhe avancimi i sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore, materiale, infrastrukturore dhe financiare.

AFTËSITË KRYESORE QË SYNOHET TË ARRIHEN NË VITIN 2019

MINISTRIA E MBROJTJES

- Krijimi i pakos së nevojshme legjislativë për funksionim të MM-së si produkt i miratimit të Ligjit për Ministrinë e Mbrojtjes, Ligjit të FSK-së dhe Ligjit për Shërbim në FSK;
- Realizimi i rishikimit të akteve nënligjore (rregulloreve dhe udhëzimeve administrative) me prioritet kritik për fushat funksionale të MM);
- Realizimi i procesit të riorganizimit (tranzicionit) të MM-së dhe risistemimit të personelit të MFSK-së në pozitë e reja në MM;
- Miratimi i Strategjisë së Mbrojtjes, Doktrinës së Përgjithshme Ushtarake; PAZH-it, PAM-it, Objektivat Vjetore të Mbrojtjes dhe TOPP-it;
- Realizimi i rishikimit të politikave, dokumenteve procedurale dhe administrative me prioritet kritik të fushave funksionale të MM-së (personel, inteligjencë, logjistikë, infrastrukturë, komunikim, mjekësi);
- Fillimi i koordinimit të politikave të mbrojtjes dhe sigurisë kombëtare me konceptin strategjik dhe politikat e mbrojtjes dhe sigurisë së NATO-s;
- Realizimi i rishikimit të marrëveshjeve të deritashme të bashkëpunimit me shtetet partnere;
- Pjesëmarrja në ushtrimet që organizohen në rajon në kuadër të ushtrimeve të përbashkëta, si “Immediate Response”, “Joint Reaction” dhe ushtrimeve tjera që parashihen në koordinim me EUCOM;
- Realizimi i procesit të rekrutimit të personelit ushtarak dhe civil sipas planit të rekrutimit për vitin 2019.

SHTABI I FSK-së

- Realizimi i procesit të tranzicionit sipas strukturës së re organizative nga KFT në SHPFISK;
- Kompletimi i doktrineve operacionale për fushat funksionale (keystone);
- Realizimi i tranzicionit të Regjimentit të Mbrojtjes Civile dhe Batalionit të Xhenios nga vartësia e BMO/KL-së në vartësi të drejtpërdrejt të SHPFISK-së me vazhdimësi të pandërprerë të operacjonalitetit të tyre si dhe deaktivizimi i Njësisë Ndërlidhëse për Reagim në Kriza (NJNRK) me integrimin e saj në RMC dhe në Kompaninë për Operacione me Civilët (KOC);
- Përcaktimi i kriterëve dhe standardeve për vlerësimin e operacjonalitetit dhe gatishmërisë operacionale të FSK-së;
- Ndërtimi i kapaciteteve të reja të infrastrukturës së akomodimit në kazermën e FSK-së
- Ndërtimi i poligonit për stërvitje taktike në KDS;
- Përcaktimi i lokacioneve për poligonet e reja për trajnime të ndryshme deri në nivel kompanie gjatë vitit 2019, si dhe vendqëndrimi dhe ndërtimi i depove të municionit artilerik;
- Realizimi i blerjes së kapaciteteve të para të armatimit për njësitë e këmbëtorisë sipas planit të logjistikës;
- Zgjerimi i infrastrukturës përmes Rrjetit Strategjik të Komunikimit në gjashtë (6) lokacione-pika të larta strategjike të tjera, që mundëson zgjerimin e kapaciteteve të sistemit të SKI-së në mbështetje të C3;

KOMANDA E FORCAVE TOKËSORE

- Realizimi i procesit përgatitor për fillimin e tranzicionit të BRSH-së në KFT;
- Realizimi i procesit të vlerësimit dhe seleksionimit të personelit dhe burimeve materiale në përputhje me specifikat e fushë-misionit të ri të këmbëtorisë;

KOMANDA E DOKTRINËS DHE STËRVITJES

- Realizimi i procesit të rishikimit të bazës ekzistuese për trajnime dhe stërvitje;
- Realizimi i programeve të reja për trajnime dhe stërvitje të këmbëtorisë bazuar në misionin e ri të FSK-së;
- Realizimi i udhëzuesëve (manualeve) dhe Procedurat Standarde Operative (PSO-të) si dhe Taktikat, Teknikat dhe Procedurat (TTP-të) me prioritet sipas Doktrinë të trajnimit;
- Realizimi i kapaciteteve me prioritet të instruktorëve dhe përgatitja e tyre për FSK-në me moton "Trajno Trajnerët";
- Realizimi i stërvitjeve shtabore në procesin e komandimit dhe drejtimit si dhe vendimmarrjes ushtarake në FSK;
- Realizimi i përgatitjes në aspektin taktik të stafit komandues për detyrat shtabore.

KOMANDA E LOGJISTIKËS

- Realizimi i mbështetjes logjistike në furnizim, transport dhe mirëmbajtje për njësitë që zhvillojnë procesin e tranzicionit dhe dislokimit të mundshëm;
- Realizimi i mbështetjes logjistike në furnizim, transport dhe mirëmbajtje për njësitë që mirëmbajnë, ruajnë dhe zhvillojnë detyrat në zbatim të misionit ekzistues të FSK-së deri në tranzicionin e tyre sipas planit;
- Përmbyllja e procesit të rishikimit të burimeve ekzistuese materiale të trashëguara nga FSK-ja;

- Realizimi i rishikimit dhe zbatimit të PSO-ve për sistemin e transportit, furnizimit dhe mirëmbajtjes sipas rolit dhe përgjegjësi të reja;
- Realizimi i procesit të vlerësimit të cilësisë së sistemit të mirëmbajtjes dhe riparimit të automjeteve dhe pajisjeve;
- Realizimi i procesit të riorganizimit të Regjimentit të Mjekësisë sipas rolit dhe përgjegjësi të reja.

PRIORITETET KRYESORE NË FUNKSION TË REALIZIMIT TË OBJEKTIVAVE AFATMESME NË VITIN 2019

VITI-2019

1. MINISTRIA E MBROJTJES -MM

1.1. Procesi i hartimit të akteve ligjore dhe nënligjore

Me miratimin e ligjeve për mandat të ri për MM dhe FSK që kanë të bëjnë me Forcën e Sigurisë së Kosovës, ka ndryshuar i tërë kuadri ligjor parësor. Miratimi i ligjeve përkatëse, mbi bazën e rekomandimeve të dala nga RSSS, determinojnë nevojën që në mënyrë obliguese të fillojë iniciimi i procedurave për plotësim/ndryshimin e të gjitha akteve nënligjore ekzistuese, dhe atë në pajtim me ndryshimet e legjislacionit parësor, në funksion të përmbushjes së misionit të ri kushtetues dhe ligjor.

Aktet nënligjore me prioritet për vitin 2019, pas miratimit të ligjeve për Ministrinë e Mbrojtjes, për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe për Shërbim në FSK, janë:

- Rregullorja për organizimin dhe sistematizimin e vendeve të punës në MM dhe Shtabin e Përgjithshëm të FSK-së;
- Rregullorja për risistemimin e pjesëtarëve të MM/FSK-së;
- Udhëzimin Administrativ mbi procesin e planifikimit në MM dhe FSK;
- Rregullorja për uniformat dhe dukjen e personelit të MM/FSK-së;
- Rregullorja -Kodi Disiplinor i MM/FSK-së;
- Rregullorja-Kodi i Mirësjelljes;
- Rregullorja për emblemat dhe simbolet e MM/FSK-së;
- Rregullorja për orarin e punës në MM/FSK etj.

**Aktet tjera nënligjore që do t'i nënshtrohen procesit të rishikimit dhe hartimit në përputhje me misionin, detyrat dhe përgjegjësitë e reja të MM –së dhe FSK-së janë të pasqyruara në Shtojcën A.*

1.2. Procesi i tranzicionit të MFSK/FSK-së në MM/FSK

Pas miratimit të ligjeve: për MM, FSK dhe Shërbim në FSK, që nënkupton ditën A, ka filluar procesi i implementimit të Planit Gjithëpërfshirës të Tranzicionit (2019-2028). Ky plan për periudhën e vitit të parë është i ndarë në 3 periudha katër-mujore. Fokusi kryesor gjatë katërmujorshit të parë (120 ditë) do të jetë përgatitja për riorganizimin e Ministrisë së FSK-së në Ministri të Mbrojtjes dhe KFT-së në Shtabin e Përgjithshëm të Forcës së Sigurisë të Kosovës. Staf i udhëheqës gjatë tranzicionit si KOMFSK, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorët e Drejtorive

në MM dhe liderët tjerë ushtarakë të FSK-së janë drejtuesit të cilët do t'i bartin përgjegjësitë për menaxhimin e procesit të tranzicionit. Kjo nënkupton faktin se pas vendimit të miratimit të ligjeve, periudha e tranzicionit të MFSK-së në MM dhe KFT-së në SHPFSK do të jetë 120 ditë, dhe pastaj do të jenë 240 ditë shtesë, brenda të cilave MM dhe SHPFSK do të arrijnë kapacitetet e para funksionale dhe vendosjen e personelit në pozicione të reja.

Përpjekje tjetër kryesore gjatë kësaj faze, përveç vendosjes së kuadrit ligjor, do të jetë edhe hartimi i dokumenteve strategjike dhe vendosja e bazës doktrinare si parapërgatitje për riorganizimin e komandave kryesore në fazat e mëtejme.

1.3. Miratimi i draft-dokumenteve kryesore strategjike

Gjatë fazës përgatitore për procesin e tranzicionit, Komisioni për implementim të rekomandimeve të RSSS-së ka hartuar draftet e dokumenteve kryesore doktrinarë, strategjike, dhe planifikuese. Gjatë kësaj periudhe (2019) këto dokumente do t' i nënshtrohen procesit të rishikimit final dhe miratimit të tyre. Në këtë kuadër nënkuptohet rishikimi dhe miratimi i Strategjisë së Mbrojtjes, kontributi i MM/SHPFSK në hartimin e Strategjisë së Sigurisë të Kosovës, po ashtu zhvillimit të koncepteve e politikave të mbrojtjes dhe sigurisë si dhe procesit të planifikimit, programimit, buxhetimit dhe ekzekutimit strategjik.

Pas Strategjisë së Mbrojtjes, ndër dokumentet strategjike që do të shqyrtohen dhe miratohen gjatë këtij viti janë:

- Strategjia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore;
- Doktrina e Përgjithshme Ushtarake –DPU-1;
- Politika e Rekrutimit, Filtrimit dhe Përzgjedhjes për Shërbim në FSK etj.

**Kuadri i dokumenteve të tjera strategjike të planifikuara për hartim gjatë periudhës përkatëse është i pasqyruar në Shtojcën B.*

1.4. Miratimi i draft-dokumenteve kryesore planifikuese

Pas miratimit të Planit Gjithëpërfshirës të Tranzicionit, Strukturës Organizative, Deklaratës së Misioneve, Detyrave dhe Përgjegjësi, Tabelës Organizative dhe të Pajisjeve (TOP) të MM/FSK dhe Strategjisë së Mbrojtjes do të zhvillohet procesi i rishikimit dhe miratimit të Planit Afatgjatë Zhvillimor (A+10), Planit Afatmesëm (2019-2023) dhe Objektivat Vjetore të Mbrojtjes.

1.5. Fillimi i procesit të zhvillimit të politikave të mbrojtjes

Me ndryshimin e misionit imponohet nevoja edhe e rishikimit të procesit të zhvillimit të politikave të mbrojtjes dhe procesit të planifikimit strategjik të mbrojtjes. Përveç tjerash, gjatë periudhës (2019) MM do të zhvillojë dhe definojë përmes një koncept-dokumenti përkatës:

Procesin e koordinimit të politikave të mbrojtjes dhe sigurisë kombëtare me konceptin strategjik dhe politikat e mbrojtjes dhe sigurisë së NATO-s;

Procesin e koordinimit të politikave kombëtare të mbrojtjes dhe sigurisë me politikat e Ministrisë së Mbrojtjes;

Procesin e koordinimit të politikave ndërsektoriale në Ministrinë e Mbrojtjes;

Definimin e formave të administrimit të politikave në lidhje me SHPFSK-në.

1.6. Koordinimi ndërministror dhe ndërinstitutional për menaxhimin e krizave

MM në kuadër të përgjegjëseve të saj kushtetuese do të zhvillojë politikat e reja në funksion të koordinimit ndërinstitutional dhe ndërministror si me ZKM, MPB, MPJ, MSH, MI, MMPH etj., me qëllim të fuqizimit të sistemit për menaxhimin e krizave me mekanizmat tjerë të sigurisë shtetërore (AME, PK, AKI etj.). Misioni i ri i MM-së dhe FSK-së do të determinojë nevojën e shqyrtimit të politikave dhe planeve strategjike shtetërore si Planin e Reagimit Kombëtar (PRK) dhe Sistemin e Integruar për Menaxhimin e Emergjencave (SIME) me qëllim të riformulimit të përgjegjëseve të MM-së dhe FSK-së në relacion me përgjegjësitë e aktorëve tjerë institucionale në rast të reagimit kombëtar ndërministror. Koordinimi i MM-së dhe FSK-së do të zhvillohet edhe në fuqizimin e partneritetit dhe koordinimit të aktiviteteve me strukturat ndërkombëtare të sigurisë në vend (KFOR-it).

Gjatë vitit 2019 do të punohet në zhvillimin e politikave dhe planeve që ndërlidhen me aktivitetet e Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së, në fushën e menaxhimit të krizave, duke përfshirë fushën e bashkëpunimit civilo-ushtarak, koordinimin e operacioneve të deminimit humanitar, operacioneve për asgjësimin e mjeteve të pashpërthyera (EOD), planeve për mobilizim dhe Host Nation Support-HNS (Mbështetjen e Vendit Mikpritës).

Do të vazhdohet me koordinimin e aktiviteteve të MM-së dhe FSK-së në fushën e menaxhimit të krizave dhe bashkëpunimit civilo-ushtarak me Ministrinë dhe Agjencitë tjera Qeveritare, OJQ-të kombëtare dhe ndërkombëtare, komunat si dhe me të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, me qëllim të ofrimit të ndihmës dhe në të njëjtën kohë realizimin e misionit të MM –së dhe FSK-së në fushën e menaxhimit të krizave dhe bashkëpunimit civilo-ushtarak në përgjithësi.

Në mbështetje të objektivave afatmesme do të punohet në hartimin dhe përshtatjen e politikave dhe planeve për vlerësimin dhe menaxhimin e krizave (reale), duke ndjekur gjithmonë tendencat e strukturave homologe me qëllim që të arrihet niveli i dëshiruar.

1.7. Vazhdimi i bashkëpunimit ndërkombëtar me synim anëtarësimin në iniciativat rajonale dhe integrimin në NATO

Synimi i PAM-it në mbështetje të objektivave afatmesme në fushën e bashkëpunimit ushtarak ndërkombëtar është vazhdimi dhe avancimi i bashkëpunimit dypalësh dhe shumëpalësh me vende të reja mike, më të cilat FSK-ja mund të ketë bashkëpunim në të ardhmen si dhe angazhimi në iniciativa dhe stërvitje rajonale.

Në mbështetje të objektivave afatmesme do të punohet në zgjerimin dhe rritjen e bashkëpunimit ushtarak të ndërsjellë dhe të arritjes së marrëveshjeve dypalëshe, shkëmbimin e informacioneve dhe përvojave për çështjet e sigurisë në rajon dhe më gjerë. FSK-ja do të angazhohet dhe do të merr pjesë aktive për të kontribuar në realizimin e të gjitha programeve relevante të strukturave euro-atlantike dhe në kuadër të iniciativave rajonale.

Një ndër synimet e rëndësishme është anëtarësimi në Programin e Partneritetit për Paqe (PfP) me qëllim të ngritjes së raporteve formale me NATO-në dhe përmbushjes së standardeve që do t'i ndihmojnë Kosovës në rrugën e anëtarësimin të plotë në NATO. Ky koordinim duhet të jetë në bashkëpunim me partnerët dypalësh përmes mekanizmave dhe iniciativave rajonale për anëtarësim në RACVIAC si dhe mekanizma dhe organizata tjera të sigurisë.

Gjithashtu, përfaqësimi ushtarak në strukturat ndërkombëtare dhe vendosja e atashëve ushtarakë do të bëhet në përputhje me prioritetet e politikave të mbrojtjes dhe dinamikës së zhvillimit të Forcave tona. Prioritet për vitin 2019 janë Franca, Italia etj..

1.8. Zgjerimi i bashkëpunimit dypalësh me Forcat e Armatosura të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, vendeve të rajonit NATO-s dhe BE-së

Gjatë vitit 2019 do të vazhdohet me sinkronizimin e të gjitha aktiviteteve me Zyrën e Bashkëpunimit të Mbrojtjes të SHBA-ve (US ODC) dhe Gardën Kombëtare të Ajovës (IOWA-së) për të gjitha fushat, si dhe do të bëhet vlerësimi dhe identifikimi i kërkesave të MM-së dhe FSK-së për ngritjen e kapaciteteve të reja për këtë periudhë në mënyrë që me kohë të arrihet edhe koordinimi i mbështetjes nga struktura ushtarake të SHBA-së.

Në mbështetje të këtij objekti do të punohet në zgjerimin dhe rritjen e bashkëpunimit ushtarak të ndërsjellë dhe të arritjes së marrëveshjeve dypalëshe me fokus zgjerimin e edukimit dhe trajnimit të stafit ushtarak dhe civil, shkëmbimin e eksperiencës dhe dërgimin e kadetëve të ri në akademitë ushtarake të vendeve të NATO-së. Ministria në bashkëpunim me Forcën, në vazhdimësi, të hartojë plane dypalëshe vjetore me vendet që momentalisht kemi marrëveshje bashkëpunimit si dhe plane të veprimit për bashkëpunim ushtarak, për të zhvilluar kapacitete të reja operacionale të njëjësive për pjesëmarrje në stërvitje dhe gara të përbashkëta brenda dhe jashtë vendit, me qëllim të përgatitjes së FSK-së për pjesëmarrje në operacione paqeruajtës dhe humanitare. Pas kalimit në MM/FSK parashihet që të rishikohen të gjitha marrëveshjet e deritashme të bashkëpunimit me shtetet si në vijim: SHBA-Ajova, Mbretëria e Bashkuar, Lituania, Holanda, Turqia, Shqipëria, Maqedonia, Mali i Zi, Kroacia, Letonia, Gjermania, Sllovenia etj.. Gjithashtu do të bëhet edhe rishikimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit që aktualisht i kemi në fushat specifike qoftë për mbështetje në aktivitete trajnuese, pajisje apo dhe shkëmbime kulturore dhe oficerëve në mënyrë të ndërsjellë siç është rasti me Republikën e Shqipërisë dhe atë të Turqisë.

1.9. Pjesëmarrja aktive dhe kontributi substancial i FSK-së në ushtrimet, organizatat, iniciativat rajonale si dhe në ndërtimin e stabilitetit dhe bashkëpunimit rajonal

Synimet tona për pjesëmarrjen aktive dhe kontributin substancial të FSK-së në ushtrimet, organizatat, iniciativat rajonale si dhe në ndërtimin e stabilitetit dhe bashkëpunimit rajonal, edhe gjatë kësaj periudhe, ndër tjera, do të vazhdojë të jetë pjesëmarrja në ushtrimet që organizohen në rajon në kuadër të ushtrimeve të përbashkëta si “Immediate Response”, “Joint Reaction” dhe ushtrimeve tjera që parashihen në koordinim me EUCOM.

1.10. Riorganizimi i personelit sipas strukturës organizative të MM/FSK dhe avancimi i sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore

Menaxhimi i burimeve njerëzore (sipas Strategjisë së miratuar të burimeve njerëzore), në mbështetje të objektivave afatmesme do të vazhdojë të orientohe në pesë fushat kryesore: Rekrutimi, Verifikimi, Zhvillimi profesional, Zhvillimi i Karrierës dhe Motivimi i personelit. Në fillim të fazës së parë të 120 ditëve të para të vitit 2019, gjatë tranzicionit të Ministrisë së Mbrojtjes dhe SHPFSK-së, do të kryhen edhe procedurat për tranzicion të kuadrit të personelit, bashkë me autoritetin, detyrat dhe përgjegjësitë e reja të cilat do t'u transferohen departamenteve përkatëse të MM-së dhe SHPFSK-së.

a. Procesi i rekrutimit dhe mbajtja e personelit- Procesi i rekrutimit do të zhvillohet sipas planit paraprak dhe sipas nevojave e kërkesave të komponentëve/njësisë të MM/FSK-së, duke ruajtur parimin e barazisë kushtetuese të të gjithë qytetarëve, duke i respektuar të drejtat dhe garantuar mundësinë për të aplikuar, garuar dhe përzgjedhur në të gjitha komponentët e MM/FSK-së. Edhe gjatë kësaj periudhe, rekrutimi do të jetë proces i vazhdueshëm i cili do të zhvillohet në përputhje me procedurat e standardizuara dhe hapat e planifikimit që çojnë në

realizimin e suksesshëm të tij. Për një proces të rregullt dhe kualitativ do të zhvillohen procedurat e shqyrtimit, filtrimit dhe përzgjedhjes në bazë të rregullores përkatëse. Procesi i rekrutimit të specialistëve si dhe afatet kohore do të zhvillohen dhe përcaktohen në pajtim me nevojat dhe prioritetet e MM/FSK-së dhe njësive të saj, por edhe në pajtim me objektivat dhe prioritetet e MM-së që dalin me qëllim të funksionalizimit të mëtejshëm të FSK-së.

Në kuadër të MM-së, përveç procesit të risistemimit të personelit ekzistues të MFSK-së do të kemi edhe procesin e rekrutimit për të përmbushur numrin e nevojshëm për vitet 2019-2023. Personeli i ri i rekrutuar në FSK gjatë këtyre viteve do të jetë si në vijim :

- 1). Në vitin 2019 do të jenë 311 rekrutë, 33 civilë dhe 18 kadetë;
- 2). Në vitin 2020 do të jenë 312 rekrutë 40 civilë dhe 20 kadetë;
- 3). Në vitin 2021 do të jenë 371 rekrutë, 26 civilë dhe 22 kadetë;
- 4). Në vitin 2022 do të jenë 312 rekrutë dhe 28 kadetë; si dhe
- 5). Në vitin 2023 do të jenë 253 rekrutë dhe 18 kadetë.

**Plani i rekrutimit për periudhën afatmesme 2019-2023 është pasqyruar në Shtojcën C*

1.11. Avancimi i sistemit të inteligjencës dhe sigurisë

Për realizimin sa më të suksesshëm dhe efikas të detyrave dhe përgjegjësi në nivelin strategjik, gjatë kësaj periudhe, komponenti i sistemit të inteligjencës dhe sigurisë do të fokusohet në: trajnimin e stafit, zhvillimin e politikave për siguri fizike, sigurinë e personelit, sigurinë e dokumenteve, mbështetjen për sigurinë kibernetike (në bashkëpunim me komponentin e sistemit të komunikimit dhe informatikës), zhvillimin e politikave të inteligjencës; menaxhimin e informatave strategjike; përgatitjen e produkteve inteligjente për vendimmarrësit, paralajmërimin dhe raportimin për kundër-inteligjencë dhe kundër-terrorizëm në koordinim me Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë, Policinë e Kosovës dhe institucionet tjera brenda dhe jashtë vendit.

1.12. Zhvillimi i sistemit të arsimimit ushtarak për personelin e forcave ushtarake

PAM 2019-2023, si objektiv në vete përmban edhe ngritjen e nivelit të arsimimit dhe profesionalizimit të pjesëtarëve të forcave, me qëllim të përmbushjes së misionit dhe rritjes së aftësive dhe gatishmërisë operacionale në nivel sa më të lartë.

Politikat e arsimimit ushtarak do të konsistojnë në:

- organizimin, zhvillimin, drejtimin dhe realizimin e përgatitjes, arsimimit e kualifikimit të oficerëve, nënoficerëve e drejtuesve të FSK-së;
- zhvillimin e konceptit të programeve të arsimimit dhe doktrinës së organizimit dhe përdorimit të Forcës së Sigurisë të Kosovës ;
- përpunimin dhe zbatimin e standardeve dhe kërkesave për arsimim në funksion të rritjes së aftësive të FSK për të përmbushur misionin e tyre kushtetues dhe standardet e anëtarësimit në organizatat e sigurisë rajonale dhe ndërkombëtare;
- realizimin dhe mbështetjen e procesit mësimor në institucionet arsimore dhe në trupa;
- shtimin dhe përmirësimin e bazës mësimore didaktike dhe i mjeteve të automatizimit në interes të procesit stërvitor si dhe kompletimi me mjetet e mbështetjes;
- kualifikimet e reja në kuadër të modernizimit të sistemit arsimor e ushtarak në KDS;
- realizimin dhe mbështetjen e procesit mësimor në institucionet arsimore dhe në trupa, për kryerjen e kurseve të parashikuara në planin afatmesëm të zhvillimit të Forcave;
- mbështetjen e arsimimit me botime doktrinare, manuale, tekste etj.;
- fillimin e punës për ngritjen e Qendrës Simulative për përgatitjen e oficerëve të shtabit.

Për zbatimin e kësaj politike, MM/FSK do të:

- shfrytëzojnë në radhë të parë kapacitetet e veta profesionale (KDS), në ngritjen e njohurive profesionale përmes programeve të ndryshme;
- sigurojnë përmes bashkëpunimeve të ndryshme brenda vendit shkollime universitare të niveleve të ndryshme qoftë në universitete publike apo private;
- shfrytëzojnë mundësitë e arsimit dhe ngritjes profesionale, në përputhje me nevojat e institucionit, nëpër qendrat e NATO-s dhe vendeve të tjera në kuadër të marrëveshjeve ekzistuese dhe marrëveshjeve të reja të bashkëpunimit.

1.13. Zhvillimi i sistemit të mbështetjes logjistike dhe zgjerimit të infrastrukturës për krijimin e kushteve të njësive të ngritura të FSK-së për punë, jetë dhe mësim

MM dhe SHPFSK, gjatë zhvillimit dhe realizimit të procesit të tranzicionit dhe ngritjes së njësive të FSK-së, në këtë periudhë, do të fokusohen edhe në zhvillimin strukturor të sistemit të mbështetjes logjistike dhe arritjen e kapaciteteve të mjaftueshme të resurseve materiale me blerjen e sistemeve të pajisjeve, automjeteve, armatimit dhe municionit për misionin e ri me qëllim të ndërtimit të logjistikës në fazën I-rë, kështu që të mbështesim ndryshimet thelbësore në strukturën e forcave në fazën I-rë deri në fazën e III-të. Mbështetja logjistike do të jetë permanente gjatë të gjithë procesit të tranzicionit dhe mbështetjes së kapaciteteve ekzistuese në përputhje me misionin aktual, krahas procesit të tranzicionit respektivisht ristrukturimit të BMO-së në Komandë të Logjistikës. Realizimi i objektivave afatmesëm në fushën e Logjistikës do të fokusohet në katër fushat kryesore të logjistikës: transport, furnizim, mirëmbajtje dhe infrastrukturë. MM dhe SHPFSK gjatë vitit 2019 do të përgatisin pakon e dokumenteve kryesore të fushës së logjistikës. **Transporti-MM** së bashku me SHPFSK-së deri në fund të vitit 2019 do të hartojnë politikën mbi ndarjen e automjeteve, pajisjeve, furnizimit dhe mirëmbajtjes. Automjetet transportuese do të ristrukturohen në atë mënyrë që të kemi disponueshmëri dhe shfrytëzim racional e efikas të tyre. Automjetet do të ndahen në shtatë (7) kategori: Automjete të blinduara (A1), Automjete taktike (A2), Automjete për komunikim dhe kontroll (B1), Automjete për transportin e personelit-BUS, minibus, kombi PKV etj. (B2), Automjete për transportin e materialeve logjistike-Kamion të ndryshëm transporti (B3), Automjete të ndihmës së parë-Autoambulanca (B4), Automjete dhe pajisje të xhenios (C).

Furnizimi-Gjatë vitit 2019 do të zhvillohet procesi i ristrukturimit të pajisjeve dhe resurseve tjera materiale (logjistike) nga njësitë e FSK-së në bazë të planit të tranzicionit dhe TOPP-it të ri. Në këtë periudhë kohore nga MM dhe SHP FSK-së do të hartohen edhe politikat për pajisjet dhe furnizimin. Gjithashtu do të rishikohet plani i furnizimeve dhe do të bëhet decentralizimi i sistemit të furnizimeve në nivel të brigadave.

Menaxhimi dhe administrimi i resurseve materiale do të zhvillohet me:

- Procesin e standardizimit dhe kodifikimit të pajisjeve dhe resurseve të tjera materiale (automjetet, armët etj.);
- Procesin e çregjistrimit/shkarkimit nga ato të panevojshme dhe të pashfrytëzueshme; dhe
- Sistemin e menaxhimit të aseteve në kuadër të Sistemit të Menaxhimit të Informacionit (SMI).

Strukturat drejtuese dhe menaxhuese të mbështetjes logjistike të MM-së dhe SHPFSK-së do të hartojnë aktet nënligjore dhe dokumentet doktrinarë që legjitimojnë dhe rregullojnë sistemin e funksionimit të fushave kryesore të mbështetjes logjistike si: Rregullorja për armë dhe municion,

Rregullorja për transportin tokësor të mallrave të rrezikshëm, Doktrina e logjistikës, Koncepti i zhvillimit të logjistikës etj.

**Projektet infrastrukturore, sistemet e pajisjeve dhe sistemet e armatimit të planifikuara për periudhën afatmesme 2019-2023 janë të pasqyruara në Shtojcën F.*

1.14. Zhvillimi i sistemit të komunikimit dhe informatikës

Përgjegjësit e Komunikimit dhe Teknologjisë Informative në MM/SHPFSK gjatë kësaj periudhe synim kryesor do të kenë: vendosjen e bazave doktrinare dhe konceptuale; gatishmërinë e sistemeve, rrjeteve dhe pajisjeve të komunikimit; mirëmbajtjen e pajisjeve dhe të sistemeve ekzistuese të komunikimit, të cilat plotësojnë kriteret e FSK-së; mbështetjen e njësive të FSK-së në kohë paqeje dhe në kriza gjatë operacioneve brenda dhe jashtë vendit, me komunikim të mbrojtur në të gjitha nivelet përmes projektit COMSEC dhe INFOSEC; blerjen e pajisjeve dhe implementimin e komandë-kontroll-komunikimit (C3) si dhe ngritja e sistemeve të reja të komunikimit për përdorim strategjik, operativ dhe taktik që do të sigurojnë ndërveprueshmëri me agjencitë tjera shtetërore dhe partnerët tanë ndërkombëtarë. Sistemet e komunikimit, në mbështetje të objektivave afatmesme, do të zhvillohen në gjashtë fusha: infrastrukturë të SKI-së, pajisje të SKI-së, rrjete të teknologjisë informative, automjete taktike të SKI-së, mirëmbajtje të pajisjeve të SKI-së dhe siguri të rrjeteve. Gjatë vitit 2019 do të hartohet dhe rishikohet dokumentacioni i nevojshëm për sistemet e komunikimit dhe informacionit. Detyrat e Departamentit të KTI-së për këtë periudhë lidhur me trajnimin janë: Përgatitja e propozimeve për hartimin e plan-programeve të reja nga lëmi i komunikimit për të gjitha nivelet e trajnimeve, dhe Zhvillimi i programeve të reja të trajnimit sipas zhvillimeve të fundit të teknologjisë.

VITI 2019

2. SHTABI I PËRGJITHSHËM I FORCËS SË SIGURISË TË KOSOVËS(SHPFSK)

2.1. Tranzicioni i KDS-së dhe BMO-së në Komandën e Logjistikës (KL)

Pas riorganizimit dhe vendosjes së MM-së dhe SHPFSK-së, sipas planit paraprak do të vazhdojë tranzicioni me mision të ri i KDS-së dhe BMO-së në Komandën e Logjistikës. Bazuar në prioritetet e dala nga Rishikimi Strategjik i Sektorit të Sigurisë kjo fazë e zhvillimit do të fokusohet në ngritjen e kapaciteteve trajnuese dhe logjistike të mbështetjes qendrore. Gjatë kësaj periudhe kohore fokusi do të jetë në mbajtjen e aftësive ekzistuese nën komandim- kontroll të SHPFSK-së dhe në mirëmbajtjen e gatishmërisë së nevojshme operacionale për mbështetjen e duhur për Qeverinë e Kosovës, me aftësitë dhe kapacitetet të cilat janë përgjegjësi aktuale e FSK-së sipas Planit të Reagimit Kombëtar. Procesi i tranzicionit të KDS-së dhe BMO-së në KL do të zhvillohet gjatë periudhës e katër-mujorit të dytë, pas kësaj periudhe njësitet fillojnë misionin e ri me strukturën e re të përcaktuar me TOPP për FSK-në. Po ashtu fokus kryesor të jetë ngritja e aftësive të mirëmbajtjes si aset qendror në nivel të II-të dhe III-të, e aftë të ofrojë mbështetje qendrore për njësitet me shërbime esenciale dhe pajisje individuale.

2.2. Zhvillimi i kuadrit doktrinar dhe planifikues në nivelin operacional dhe taktik

SHPFSK bashkë me strukturat e KDS-së do të fillojnë angazhimin për kompletimin e kuadrit të dokumenteve me rishikimin, plotësimin, ndryshimin e dokumenteve ekzistuese operacionale dhe taktike (doktrinat e fushave funksionale, konceptet operacionale, udhëzuesit, doracakët, manualët, direktivat, Procedurat Standarde Operative (PSO) dhe Taktikat, Teknikat dhe Procedurat (TTP). Në përputhje me misionin e ri (të mbrojtjes territoriale) dhe hartimin e

dokumente tjera do të përmbushin infrastrukturën e nevojshme doktrinare, konceptuale dhe procedurale për funksionalitet të mirëfilltë dhe profesional në përputhje me rolin, detyrat dhe përgjegjësitë e reja. Fokus primar do të kenë dokumentet me prioritet që do të shërbejnë në funksion të mbajtjes së gjendjes së gatishmërisë së kapaciteteve dhe aftësive aktuale operacionale dhe atyre që do të ngritën e zhvillohen sipas PGJT-së dhe PAZH-it. Për hartimin e tyre do të angazhohen edhe përfaqësuesit nga NALT-i dhe partnerët tjerë të cilët do të ofrojnë eksperiencën e tyre profesionale dhe të shtabeve e forcave të armatosura të vendeve prej nga vijnë. Me këtë synohet që këto dokumente të jenë në harmoni të plotë me standardet më të avancuara të vendeve të NATO-s dhe vetë organizatës së NATO-s në aspektin e planifikimit, organizimit, drejtimit, kontrollit dhe ekzekutimit në mënyrë që të i paraprijmë procesit të integritetit në strukturat pararendëse të NATO-s si dhe të gatshëm në aspektin e pajtueshmërisë dhe ndërveprimit të ardhshëm operacional e taktik.

**Dokumentet e fushave funksionale të nivelit operacional dhe taktik të cilat janë planifikuar të rishikohen dhe hartohen gjatë kësaj periudhe janë të pasqyruara në Shtojcën B.*

2.3. Mirëmbajtja e aftësive ekzistuese operacionale të Regjimentit të Mbrojtjes Civile dhe Batalionit të Xhenios

Me synim të ruajtjes, mirëmbajtjes dhe zhvillimit të mëtejshëm të aftësive të plota operacionale të kapaciteteve ekzistuese të mbrojtjes civile dhe të xhenios, SHPFSK-së krahas procesit të tranzicionit të komandave kryesore, dhe vazhdimit të procesit të zhvillimit të aftësive bazuar në konceptin e përgjithshëm, njëkohësisht do të mbajnë aftësitë ekzistuese në kuadër të Regjimentit të Mbrojtjes Civile dhe Batalioni i Xhenios për mbështetje të autoriteteve civile. RMC dhe BXH do të ruajnë aftësitë e tanishme dhe do të kalojnë nën komandim të SHP të FSK pas A+120, deri në formimin e komponentëve të Gardës Kombëtare. Njësia Ndërlidhëse për Reagim në Kriza (NJNRK) do të pushojë aktivitetin dhe do të integrohet në RMC-në në mbajtjen e aftësive ekzistuese.

Prioritetet kryesore në fushën e operacioneve gjatë periudhës afatmesme do të jenë:

- Mirëmbajtja dhe avancimi i aftësive të tanishme operacionale të Regjimentit të Mbrojtjes Civile dhe Batalionit të Xhenios për MUAC në përputhje me misionin aktual dhe
- Zhvillimi i kapaciteteve dhe aftësive operacionale për dërgim në misione jashtë vendit për kërkim-shpëtim dhe deminim.

Edhe pas ndryshimeve ligjore dhe tranzicionit të FSK-së, qysh në vitin e parë pas tranzicionit, rëndësi e posaçme do të i kushtohet mirëmbajtjes dhe zhvillimit të vazhdueshëm të kapaciteteve dhe aftësive aktuale operacionale të RMC-së dhe BXH-së për të kryer operacionet e reagimit ndaj krizave në Kosovë dhe jashtë saj; operacionet e mbrojtjes civile brenda Kosovës; si dhe ndihmës së autoriteteve civile në përgjigje ndaj katastrofave natyrore dhe emergjencave të tjera. Detyra të tilla do të përfshijnë kapacitetet tona si në vijim:

- **Njësitë e kërkim-shpëtimit** në male, ujëra dhe ambiente urbane do të jenë të gatshme për reagim në operacionet e kërkim-shpëtimit në mbështetje të autoriteteve civile të vendit dhe vendeve në rajon. Në kuadër të planit të projekteve infrastrukturore për vitin 2019 do të angazhohemi për ngritjen e infrastrukturës për trajnim në kërkim-shpëtim urban dhe certifikimin e këtyre kapaciteteve nga mekanizmat zyrtarë të autorizuar ndërkombëtarë (INSARAG), nënkupton legjitimitimin e këtyre kapaciteteve dhe aftësive operacionale për pjesëmarrje funksionale në misione jashtë vendit.
- **Ndërtimi i Qendrës Rajonale të Trajnimit për Kërkim-Shpëtim** është një ndër synimet e periudhës afatmesme. Si projekt i trashëguar strategjik nga MFSK/FSK do të vazhdojë edhe në mandatin e MM/FSK-së.

- **Njësitë e deminimit** do të vazhdojnë angazhimin e tyre në operacionet e deminimit humanitar dhe asgjësimit të mjeteve të pashpërthyer. Gjithashtu do të vazhdojë furnizimi me pajisjet e nevojshme dhe ato specialistike për të ngritur edhe më tej nivelin e operacionalitetit dhe sigurisë së pjesëtarëve.
- **Njësitë e MKAB-së** do të vazhdojnë të mirëmbajnë dhe avancojnë edhe më tej aftësitë për detektimin dhe dekontaminimin e materieve të rrezikshme. Këto operacione specifike dhe të ndjeshme do të realizohen në përputhje me PSO-të, planet dhe udhëzuesit paraprak si dhe në bashkëpunim me aktorët tjerë. Trajnimi dhe modernizimi i kësaj njësie do të vazhdojë në kuadër të bashkëpunimit rajonal dhe me partnerët tanë nga ushtria amerikane.
- **Njësitë e xhenios**, përveç mbështetjes së vazhdueshme për nevojat operacionale të brendshme të forcave, këto njësi do të jenë të gatshme edhe në mbështetjen e projekteve humanitare.

2.4. Mirëmbajtja e gatishmërisë operacionale

Bazuar në Planin Afatgjatë Zhvillimor, njësitë e FSK-së do të kenë tri nivele të zhvillimit të aftësive operacionale. Gjatë vitit 2019, MM do të hartojë kriteret dhe standardet për vlerësimin e operacionalitetit të FSK-së, duke i përshtatur ato me normat dhe standardet më të avancuara për vlerësim të operacionalitetit.

Mbi bazën e Rregullores për vlerësimin e operacionalitetit, SHPFSK/G3-KDS do të hartojë PSO-të që do të sqarojnë në detaje kriteret për analizën dhe vlerësimin e kapaciteteve, aftësive dhe gatishmërisë operacionale në FSK.

2.5. Krijimi i elementeve të mbështetjes qendrore logjistike

Synimet kryesore të mbështetjes logjistike nga ana e G4-SHPFSK në koordinim me Departamentin e Logjistikës të MM-së për periudhën përkatëse do të jenë:

- Zhvillimi dhe avancimi i sistemit të mbështetjes me mallra dhe shërbime gjatë tërë kohës,
- Zhvillimi dhe avancimi i sistemit të mirëmbajtjes dhe ruajtjes së pajisjeve dhe objekteve aktuale që posedojnë njësitë e FSK-së.

Infrastruktura-gjatë vitit 2019, përveç projekteve aktuale që janë në zhvillim e sipër dhe projekteve tjera të planifikuara, do të procedohen për realizim edhe këto projekte në funksion të:

- Përcaktimit të vendqëndrimeve shtesë dhe zgjerimit të hapësirave ekzistuese të Kazermave të FSK-së,
- Përcaktimit të poligoneve të reja për trajnime të ndryshme deri nivel kompanie gjatë vitit 2019,
- Përcaktimit të vendqëndrimit dhe ndërtimit të depove të municionit artilerik si dhe
- Gjatë këtij viti pritet të fillojë ndërtimi i objektit të Shtabit të Përgjithshëm të FSK-së në kazermën “Adem Jashari” në Prishtinë etj.

Gjatë vitit 2019 do të fillojë ndërtimi i kapaciteteve të reja të infrastrukturës së akomodimit në kazermën e FSK-së në Ferizaj, Ndërtimi i poligonit për stërvitje taktike-KDS etj.

**Plani i projekteve të planifikuara infrastrukturore për periudhën 2019-2023 është pasqyruar në Shtojcën F.*

d. Pajisjet-Sipas planit paraprak të prokurimit/blerjeve do të zhvillohet furnizimi me pajisje individuale, specialistike dhe kolektive (pra pajisje operacionale fushore për deminim, kërkim-shpëtim, simulator konstruktiv etj.

**Plani i blerjes së sistemeve të pajisjeve të planifikuara për periudhën afatmesme 2019-2023 është pasqyruar në Shtojcën F.*

e. Armatimi-Blerja e armatimit të ri fillon nga viti 2019 dhe do të vazhdojë për çdo vit në bazë të misionit, rolit, detyrave dhe përgjegjësi të përcaktuara në kuadër të planit të implementimit të rekomandimeve të RSSS-së, Planit Mbështetës të Logjistikës, respektivisht procesit të tranzicionit të njësive ekzistuese të FSK-së dhe ngritjes/zhvillimit të njësive të reja me fokus në kapacitetet e këmbësorisë për mbrojtje territoriale (Pushkë të standardizuara dhe armatimi i lehtë sipas PSO), ndërsa nga Lista rezervë sipas PAZH-it kemi të planifikuara blerjen e sistemeve të armëve kundërtank, granatahedhës, mitraloza, snajperë etj.

**Plani i blerjes së sistemeve të armatimit të planifikuara për periudhën afatmesme pesëvjeçare është pasqyruar në Shtojcën F.*

2.6. Zhvillimi dhe avancimi i kapaciteteve të sistemit të Komandës, Kontrollit dhe Komunikimit (C3)

Përgjegjësit e KTI-së do të hartojnë planin e saj të zhvillimit të mbështetjes së Komandës dhe Kontrollit (C2) si dhe synimit të avancimit të tij në C3 duke u bazuar në konceptin e tranzicionit të njësive të FSK-së. Zhvillimi i Sistemit të Komunikimit dhe Informacionit në mbështetje të C2 dhe C3 do të bëhet krahas zhvillimeve brenda forcës të parapara në PGJT dhe PAZH. Për t'u arritur kjo SHPFSK në periudhën përkatëse planifikon të zhvillojë projektet e komunikimit dhe teknologjisë së informacionit me qëllim të ngritjes së një sistemi të integruar unik me mundësi dhe kapacitete të zgjerimit të mëvonshëm sipas nevojave operacionale të Forcës për të mbështetur edhe platforma tjera të Komandës, Kontrollit dhe Komunikimit. Gjendja e tanishme e infrastrukturës së SKI-së është e kompletuar në MM dhe në të gjitha kazermat e FSK-së. Po ashtu çdo kazermë ka të ndërtuar qendrën komutuese që mundëson konfigurimin e rrjeteve sipas nevojave operacionale të njësive që janë të vendosura në ato objekte. Infrastruktura është e ndërtuar sipas standardeve dhe e njëjta mund të shërbejë për misionin e ri të FSK-së me disa ndryshime siç janë: ndërrimi i domenit dhe rikonfigurimi i pajisjeve ekzistuese sipas strukturës dhe misionit të ri të FSK-së.

Rrjeti Strategjik i Komunikimit do të zgjerojë infrastrukturën në pika të larta strategjike që mundëson zgjerimin e kapaciteteve të sistemit të SK-së në mbështetje të C3. Ndër projektet kryesore të cilat do të zhvillohen edhe gjatë periudhës pesëvjeçare 2019-2023 janë: Sistemi VoIP; Sistemi i kriptombrojtjes COMSEC/INFOSEC; Sistemi rezerve i rrjetit të TI-së; Sistemi i MIS-it; Automjetet e komunikimit (nyjat mobile të komunikimit); Ndërtimi i Objekteve për pajisje të komunikimit në pikat strategjike; Modernizimi i rrjeteve të TI-së; dhe Siguria Kibernetike.

Krahas zhvillimit të këtyre sistemeve në pajtueshmëri me Strategjinë Nacionale Kibernetike dhe politikave të MM-së do të vazhdohet me zhvillimin, harmonizimin dhe hartimin e politikave, udhëzuesëve në ngritjen, trajnimin dhe zhvillimin e personelit për mbrojtjen e sistemeve të ndërlidhjes dhe informacionit në MM dhe FSK. Struktura për siguri kibernetike do të ngritet sipas konceptit për siguri kibernetike të MM/SHPFSK.

**Projektet e instalimit dhe blerjes së sistemeve dhe pajisjeve të komunikimit dhe informatikës për periudhën pesëvjeçare 2019-2023 janë të pasqyruara në Shtojcën F.*

2.7. Bashkëpunimi Civilo-Ushtarak

Synimi kryesor në fushën e bashkëpunimit civilo-ushtarak edhe gjatë kësaj periudhe do të jetë mbështetja e SHPFSK-së në fushën e bashkëpunimit dhe koordinimit të aktiviteteve të strukturave ushtarake të FSK-së me komunitetin, organizatat joqeveritare vendore dhe ato ndërkombëtare. Në

fazën e parë të periudhës afatmesme, do të zhvillohet një koncept i plotë mbi strukturën e BCU-së në të gjitha nivelet e FSK-së dhe funksionimit të saj. Detyrë e vazhdueshme e strukturave të BCU-së do të jetë lehtësimi i përmbushjes së misionit të njërive në operacionet brenda vendit, duke bashkëpunuar me faktorët e rëndësishëm për realizimin e tyre.

Fushëveprimi i BCU-së gjatë periudhës (2019-2023) do të fokuset në :

- Vazhdimin e identifikimit dhe koordinimit të projekteve humanitare për komunitetet me qëllim të ngritjes së imazhit të FSK-së në të ardhmen.
- Pjesëmarrjen në çdo planifikim në kohë krize, paqëje, ushtrimi fushor etj.
- Mbajtjen e ligjëratave në fushën e BCU-s para çdo dislokimi duke njoftuar pjesëtarët e FSK-së për doket, zakonet, kulturën, traditën etj. për shtetin ku do të bëhet dislokimi.
- Mbështetjen e institucioneve të vendit, OJQ-të, agjencitë dhe qytetarët në kërkesat e tyre.

VITI 2019

KOMANDA E FORCAVE TOKËSORE-KFT

2.8. Mirëmbajtja e kapaciteteve ekzistuese operacionale për reagim të shpejtë

Gjatë vitit 2019 do të zhvillohen kapaciteteve trajnuese dhe logjistike si dhe do të zhvillohet procesi përgatitor për fillimin e tranzicionit të BRSH-së në KFT, dhe në të njëjtën kohë do të mirëmbahen kapacitetet dhe aftësitë ekzistuese operacionale me qëllim të ofrimit të mbështetjes nëse kërkohet në zonat e përgjegjësisë së batalioneve përkatëse për autoritetet lokale dhe rajonale. Gjithashtu do të zhvillohet edhe procesi i vlerësimit dhe seleksionimit të personelit dhe burimeve materiale në përputhje me specifikat e fushë-misionit të ri të këmbësorisë. Shtabi i Forcave Tokësore mban përgjegjësi për riorganizimin e njërive të saj sipas planit dhe prioritetëve. Planifikimi i riorganizimit në formë sekuencash është bërë me qëllim të parandalimit të konsekuencave të mundshme në lëvizjet e personelit, të njëjtën kohë na jep mundësi të vlerësimit për burimet njerëzore dhe vendosjen e prioritetëve në pajisje para se të fillojë dita E për KFT-në.

VITI 2019

KOMANDA E DOKTRINËS DHE STËRVITJES- KDS

2.9. Fillimi i zhvillimit të programeve të reja të trajnimeve dhe stërvitjeve sipas moduleve në FSK

Me qëllim të përmbushjes së kërkesave të parashtruara në PGJT dhe PAZH, do të synohet të sigurohet nivel i lartë i trajnimit dhe stërvitjes për të përballuar kompleksitetin e fushave të misionit të ardhshëm qoftë në nivel kombëtar apo atë ndërkombëtar. Synimi i SHPFK-së në koordinim me KDS-në gjatë kësaj periudhe, në përputhje me politikat ministrore, në fushën e trajnimeve dhe stërvitjes dhe mbështetjen e partnerëve ndërkombëtarë do të jetë:

- Rishikimi i bazës ekzistuese për trajnime dhe stërvitje;
- Mirëmbajtja e standardit ekzistues të trajnimeve për misionin e tanishëm;
- Krijimi dhe implementimi i programeve të reja për trajnim dhe stërvitje bazuar në misionin e FSK-së;
- Stërvitja me qëllim të mbajtjes së gatishmërisë së njësive të FSK-së për pjesëmarrje në ushtrimet dhe stërvitjet e përbashkëta rajonale si dhe
- Mbajtja dhe avancimi në kontinuitet i trajnimeve dypalëshe brenda dhe jashtë vendit.

Në sistemin e trajnimit në të gjitha nivelet e FSK-së, kërkesat operative do të përfshihen në doktrinën e trajnimit, mbi bazën e së cilës, gjatë vitit 2019 do të përgatiten edhe udhëzuesit (manualët), Procedurat Standarde Operative (PSO-të) si dhe Taktikat, Teknikat dhe Procedurat (TTP-të). Kështu do të jetë e mundur për t'u integruar dhe analizuar niveli i arritur i shkathtësive dhe do të ndërtohet sistemi i atillë që mundëson ndërhyrjen e drejtpërdrejtë dhe përditësimin në sistemin e trajnimit dhe statusin e gatishmërisë në FSK. Sistemi i trajnimeve do të vazhdojë të formësohet dhe të ndryshojë sipas niveleve të trajnimeve në ato: individuale, kolektive dhe të kombinuara.

- Sistemi i trajnimit institucional do të implementohet në Akademinë Ushtarake për nivelin e oficerëve, si dhe *kurset funksionale që përfshijnë zhvillimin e NOF në Shkollën e NOF, ku zhvillohen kurset sipas programit për zhvillimin e karrierës së NOF*. Pas përfundimit të shkollimit akademik destinohen për shërbim në njësi të FSK-së krahas fushës specialistike. Fushë tjetër mbështetëse e trajnimit të forcës janë trajnimet dypalëshe, në kuadër të ndërveprueshmërisë me partnerët strategjikë që e mbështesin zhvillimin e FSK-së. Gjatë kësaj periudhe do të ngritën kapacitetet e instruktorëve dhe përgatitja e tyre për FSK-në me moton "Trajnoj trajnerët". Në Qendrën Simulative do të zhvillohen stërvitjet shtabore në procesin e komandimit dhe drejtimit si dhe vendimmarrjes ushtarake në FSK. Gjithashtu, përmes simulatorëve, do të realizohet edhe përgatitja në aspektin taktik e stafit komandues për detyrat shtabore. Kapacitetet ekzistuese, që janë operacionale për misionin aktual të MUAC do të plotësohen me personel shtesë dhe pajisje përkatëse sipas TOP-it të FSK. Këto kapacitete do t'i nënshtrohen trajnimeve sipas misionit dhe sipas Listës së detyrave dhe Listës së trajnimeve për FSK-në për misionin e ardhshëm të forcave për mbrojtje territoriale.

**Plani i trajnimeve për periudhën pesëvjeçare (2019-2023) është pasqyruar në Shtojcën D.*

VITI 2019 KOMANDA E LOGJISTIKËS-KL

2.10. Mbështetja logjistike e njësive gjatë procesit të mirëmbajtjes së aftësive ekzistuese dhe procesit të tranzicionit

Përveç procesit të riorganizimit, fokusi kryesor i Komandës së Logjistikës gjatë kësaj periudhe do të jetë në dy drejtime:

- Ofrimi mbështetjes logjistike në furnizim, transport, mirëmbajtje për Njësitë që do të zhvillojnë procesin e tranzicionit dhe dislokimit të mundshëm.
- Ofrimi i mbështetjes logjistike në furnizim, transport dhe mirëmbajtje për njësitë që do të mirëmbajnë, ruajnë dhe zhvillojnë detyrat në zbatim të misionit ekzistues të FSK-së deri në tranzicionin e tyre sipas planit.

a. Transporti-Nga viti 2019 do të vazhdojë furnizimi i njësive të Forcave Tokësore me të gjitha llojet e automjeteve A1, A2, B1, B2, B3, B4 dhe C, (automjete taktike, autoblanda, automjete transportuese etj.) Do të standardizohet sistemi i transportit në të gjitha linjat e lëvizjes dhe qarkullimit të furnizimeve, pajisjeve, resurseve tjera materiale dhe personelit ushtarak si brenda ashtu edhe në rast dislokimi të forcave në operacione jashtë vendit.

**Plani i blerjes së sistemeve të automjeteve të planifikuara për periudhën pesëvjeçare 2019-2023 është pasqyruar në Shtojcën F.*

b. Furnizimi-Gjatë vitit 2019, prioritet do të jetë furnizimi me pajisje dhe resurse tjera materiale sipas TOP-it duke zhvilluar sistemin e prokurimit të resurseve materiale me identifikim të saktë të nevojave, specifikim të detajuar teknik të kërkesave në mënyrë që të kemi blerje dhe kontraktim të produkteve të kërkuara dhe të nevojshme në cilësinë dhe kohën e duhur. Gjatë kësaj periudhe pritet të rishqyrtohen edhe politikat e shërbimeve dhe furnizimeve përmes kontraktorëve privat (ushqimi, derivatet, mirëmbajtja e automjeteve dhe ndërtesave, pastrimi i hapësirave etj.). Gjatë kësaj periudhe do të i kushtohet rëndësi zhvillimit dhe avancimit të sistemit të furnizimit, jo vetëm në kushte paqeje por edhe në kohë krize brenda dhe jashtë vendit. Në kuadër të mbështetjes qendrore dhe të decentralizuar, sistemi i furnizimit do të funksionoj në relacionin nga bazat kryesore e stoqeve dhe rezervave deri në vendbazimet e njësive apo në rajonin e veprimit të njësive.

c. Mirëmbajtja-Shërbimi i mirëmbajtjes dhe riparimit të automjeteve dhe resurseve tjera materiale do të jetë sfidë edhe gjatë kësaj periudhe. Ndër hapat procedural dhe organizativ paraprak, në çdo komponentë operacionale e taktike të FSK-së do të avancohet shkalla e profesionalizmit të operatorëve dhe shfrytëzuesve të automjeteve dhe resurseve tjera materiale. Do të ngritën dhe përmirësohen njohuritë dhe vetëdija e personelit të ngarkuar dhe përdorues të pajisjeve individuale dhe specialistike si dhe ruajtja dhe përkujdesja gjatë shfrytëzimit të pajisjeve ekipore dhe kolektive duke nënkuptuar faktin se përmbushja e misionit është e ndërlikuar direkt me funksionalitetin dhe gatishmërinë e pajisjeve. Bazuar në udhëzuesin për mirëmbajtje dhe me qëllim të ngritjes së cilësisë së sistemit të mirëmbajtjes dhe riparimit të automjeteve dhe pajisjeve, ky prioritet planifikohet të realizohet gjatë periudhës pesëvjeçare (2019-2023). Prioritetet do të ndahen sipas planit të ngritjes së njësive. Do të angazhohemi për avancimin e nivelit II të mirëmbajtjes në kuadër të kazermave (Istog, Ferizaj, Gjilan, Mitrovicë, Pomozotin dhe Prizren), nivelit III në kuadër të Njesisë Qendrore të Mirëmbajtjes dhe nivelit IV gjithashtu në kuadër të Njesisë Qendrore të Mirëmbajtjes (Prishtinë) në ndërveprim me operatorët ekonomik të kontraktuar. Pajisjet e reja do të blihen duke përfshirë edhe mirëmbajtjen, pjesët rezervë dhe trajnimin për përdorimin e pajisjeve përkatëse.

d. Zgjerimi dhe avancimi i kapaciteteve të sistemit të mbështetjes mjekësore-Komponenti i mbështetjes mjekësore në nivel të FSK/KL-së gjatë periudhës pesëvjeçare (2019-2023) do të synojë: të bëjë menaxhimin e personelit shëndetësor; të mbajë, të motivojë, të avancojë, të vlerësojë, të trajnojë dhe të arsimojë personelin mjekësor në FSK; dhe të ofrojë shërbimet mjekësore (avancimi nga ROL-1 në ROL-2, funksionalizimi i Poliklinikës Mjekësore-faza-I-rë), për personelin e FSK-së në ushtrime, stërvitje, operacione të paqes dhe ato humanitare në kohë paqeje dhe krize, si dhe të jetë i gatshëm t'ju ofrojë shërbime mjekësore (sipas kërkesës së institucioneve të RKS-së) autoriteteve civile në vend dhe jashtë vendit. Strukturat mjekësore do të rrisin rolin e vet për krijimin e kushteve optimale për realizimin e misionit të FSK-së. Fokusi i punës së strukturave mjekësore të FSK-së do të jetë funksionimi i elementeve të mjekësisë dhe planifikimi i mbështetjes mjekësore. Fushëveprimi i mjekësisë do të përfshijë planifikimin e plotë për implementimin e objektivave të kapaciteteve operacionale mjekësore, informatizimin e të dhënave shëndetësore individuale, kualifikimin e personelit mjekësor, si dhe forcimin e kontrolleve periodike shëndetësore. Kjo mbështetje do të shtrihet deri në nivelin spitalor, duke ofruar shërbime në përputhje me standardet e vendeve të NATO-s. Gjatë periudhës afatmesme shërbimet mjekësore do të kenë rol parësor, gjatë gjithë kohës, në procesin e rekrutimit të pjesëtarëve të FSK-së. Në këtë aspekt SHPFK-së së bashku me komponentin mjekësor do të

ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme në pajtim me planin mbështetës të personelit për rekrutim. Gjatë vitit 2019 do të bëhet ngritja e komponentit mjekësor bazuar në misionin e ri.

VI-OBJEKTIVAT DHE AFTËSITË KRYESORE VJETORE TË SYNUARA NË VITIN 2020

OBJEKTIVAT VJETORE PËR VITIN 2020

- Përfundimi i dokumenteve strategjike dhe atyre planifikuese për Ministrinë e Mbrojtjes dhe FSK-në;
- Vazhdimi i implementimit të Planit Gjithëpërfshirës të Tranzicionit dhe planeve mbështetëse me qëllim arritjen e aftësive operacionale;
- Avancimi dhe zhvillimi i sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore, materiale, infrastrukturore, financiare, si dhe vazhdimi i avancimit të standardeve të transparencës, llogaridhënies, integritetit, besueshmërisë dhe imazhit institucional;
- Thellimi dhe zgjerimi i bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar në çështjet e mbrojtjes si dhe vendosja e marrëdhënieve formale të partneritetit të Republikës së Kosovës me NATO-n;
- Mbajtja dhe zhvillimi i kapaciteteve dhe aftësive ekzistuese për mbështetje ushtarake autoriteteve civile (MUAC);
- Zhvillimi i lidershit dhe procesit të trajnimeve për personelin e FSK-s për misionin e ri;

AFTËSITË KRYESORE QË SYNOHET TË ARRIHEN NË VITIN 2020

MINISTRIA E MBROJTJES

- Vazhdimi i hartimit të akteve normative të reja si produkt i ligjeve: Ligjit për Ministrinë e Mbrojtjes, Ligjin për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Ligjin për Shërbim në FSK;
- Hartimi i politikës për harmonizimin e procesit të planifikimit strategjik të Ministrisë së Mbrojtjes me procesin e planifikimit strategjik të NATO-së dhe sistemit të integruar të planifikimit të mbrojtjes në MM dhe SHPFSK;
- Funksionalizimi i sistemit të digjitalizimit të bazës së të dhënave të personelit;
- Realizimi i programeve relevante të strukturave euroatlantike dhe të iniciativave rajonale në funksion të anëtarësimit në Kartën e Adriatikut-A5;
- Realizimi i ushtrimit fushor ndërkombëtar në Kosovë në koordinim dhe në bashkëpunim me EUCOM dhe partnerët rajonalë;
- Hartimi i Strategjisë për anëtarësim në PfP dhe integrim në strukturat rajonale nga Ministria e Mbrojtjes dhe Ministrinë e Punëve të Jashtme;
- Realizimi i procesit përgatitor për marrëveshjet e reja me prioritet me ministritë e Mbrojtjes së Çekisë, Suedisë, Norvegjisë, Austrisë dhe Zvicrës;
- Realizimi i përfaqësimit ushtarak në strukturat ndërkombëtare dhe vendosja e atashëve ushtarakë me prioritet vendet: Francë, Itali etj.;
- Shkëputja e RMC dhe BXH nga BMO dhe kalimi nën C2 të SHPFSK;
- Mbajtja e aftësive ekzistuese të RMC-së dhe Batalionit të Xhenios (Civile);
- Strategjia e Mbrojtjes/Miratimi;
- PAZH /Miratimi;

- PAM/Miratimi;
- Deklarata e Misionit dhe TOPP;
- Strategjia për anëtarësim në PFP dhe integrim në strukturat rajonale (MM dhe MPJ);
- Blerjet e pajisjeve për mision të ri/ sipas FOCIS;
- Rekrutimi i personelit për FSK sipas planit duhet të fillojë në vitin 2019 për të pasur ushtarë të gatshëm në 2020. Sipas planit duhen 18 deri në 24 muaj për të kompletuar njësitë me ushtar, për detaje shih konceptin e rekrutimit në PGJT.

SHTABI I PERGJITHSHËM I FORCËS SË SIGURISË SË KOSOVËS

- Zhvillimi dhe realizimi i mirëmbajtjes së nivelin e duhur të kapaciteteve dhe aftësive operacionale të RMC-së dhe BXH-së për mbështetje të autoriteteve civile në gatishmërinë e plotë;
- Realizimi i procesit të ristrukturimit të objekteve infrastrukturore ;
- Vazhdimi i trajnimeve brenda dhe jashtë vendit sipas planit dhe prioriteteve (trajnimet dhe edukimet që janë kyçe për proces të tranzicionit);
- Trajnimi i instruktorëve/ Rishikimi i Plan-programeve trajnuese në KDS;
- Finalizimi dhe publikimi i doktrinave funksionale;
- Vazhdimi i përgatitjes sipas prioriteteve të dokumenteve nën-doktrinarë (Manuale, TTP dhe PSO) sipas listës së hierarkisë së dokumentacionit për FSK;
- Vendosja dhe mbajtja e K2 (Komandim Kontrollit) sipas strukturës së re;
- Trajnimi bazik për rekrut;
- Trajnimi për këmbësori në nivel T1 dhe T2 për Regjimentin e Parë të këmbësorisë; Aktivitet që ndërlihet në fushën e ngushte të përgjegjësisë së KDS-së
- Trajnimi për specialitete (Logjistikë, Komunikim, PU);
- MTT për kapiten dhe major (Version i shkurtuar i CGSC dhe CCC);
- Trajnimi për lider luftarak;

KOMANDA E FORCAVE TOKËSORE

Realizimi i procesit të tranzicionit të BRSH-së në KFT dhe BAT1/BRSH-së në REGJ1 të Këmbësorisë;

KOMANDA E TRAJNIMIT DHE DOKTRINËS

- Realizimi i ciklit të trajnimeve të planifikuara për rekrut (bazike, specialistike, trajnimeve individuale për këmbësori) dhe kuadrit të specializuar në Qendrat e Trajnimit (QTB, QTK, QTS);
- Përgatitja e ekipit për trajnime ushtarake (Military Training Team-MTT) për kapiten dhe major si version i shkurtuar i Kolegjit të Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm (Command and General Staff College-CGSC) dhe Kursi i Kapitenëve të Karrierës (Captains Career Course-CCC);
- Konsolidimi dhe përmirësimi i Qendrës së Trajnimit bazik dhe specialistik për kualifikimin e ushtarëve, nënoficerëve dhe oficerëve për të përmbushur detyrat funksionale sipas specialiteteve përkatëse;

- Funksionalizimi i kapaciteteve të Qendrës për Trajnime Kolektive për zhvillimin, kontrollimin e trajnimeve dhe mirëmbajtjen e mbështetjes ekzistuese të trajnimeve deri në nivelin e një kompanie të përforcuar;
- Realizimi i ciklit të aftësimit të instruktorëve sipas degëve dhe gjinive ushtarake (këmbësori, MKAB,, artileri, xhenio etj.) sipas planit paraparak;
- Përgatitja e instruktorëve për zhvillimin e trajnimeve në nivel togu dhe kompanie;

KOMANDA E LOGJISTIKËS

- Kompletimi i kapaciteteve teknike dhe aftësive profesionale për përmbushjen e nivelit II-të të mirëmbajtjes nëpër të gjitha kazermat e FSK-së;
- Realizimi i fazës së parë të grumbullimit të stoqeve (rezervave ushtarake) për 20 ditë operacion me mision të ri;

PRIORITETET KRYESORE NË FUNKSION TË REALIZIMIT TË OBJEKTIVAVE AFATMESME NË VITIN 2020

VITI 2020

1. MINISTRIA E MBROJTJES

1.1. Vazhdimi i hartimit të akteve të reja ligjore dhe nënligjore për MM dhe FSK

Procesi i monitorimit të implementimit të legjislacionit të plotësuar dhe ndryshuar primar dhe sekondar do të jetë proces i vazhdueshëm monitorues. Varësisht dhe bazuar në kalendarin e paraparë të veprimit, MM/FSK do të mund të shqyrtojë, analizoj dhe të inicioj hapa në drejtim të draftimit të akteve ligjore të reja primare do të vazhdojë gjatë vitit 2020.

**Aktet nënligjore me prioritet në vitin 2020 janë të pasqyruara në Shtojcën A*

1.2. Zhvillimi i sistemit të integruar të planifikimit të mbrojtjes

Me ndryshimin e misionit imponohet nevoja edhe e rishikimit të procesit të zhvillimit të planifikimit strategjik të mbrojtjes. Për shkak të rëndësisë jetike që paraqet fusha e planifikimit të mbrojtjes gjatë vitit 2020 do të zhvillohet edhe koncepti që do të përmbajë:

- Harmonizimin e procesit të planifikimit strategjik të Ministrisë së Mbrojtjes me procesin e planifikimit strategjik të NATO-s;
- Sistemin e integruar të planifikimit të mbrojtjes në MM dhe SHPFSK dhe
- Procesin e zhvillimit të mëtejshëm përmes kurseve e trajnimeve të zyrtarëve/oficerëve për fushën e planifikimit dhe programimit të mbrojtjes sipas praktikave dhe standardeve më bashkëkohore.

1.3. Digjitalizimi i bazës së të dhënave-Krahas procesit të hartimit të akteve nënligjore dhe dokumenteve procedurale e administrative (të cekura në shtojcat A dhe B), vazhdimi të procesit të rekrutimit sipas planit të rekrutimit (shtojca C) dhe atij të zhvillimit profesional (shtojca D) përgjatë vitit 2020 do të funksionalizohet edhe Baza e digjitalizuar e të dhënave. Ky sistem do të zhvillojë dhe shpejtojë procesin e komunikimit të informacionit të cilin e bënë më të përdorshëm përmes softuerëve përkatës. Funksionalizimi i data-bazës do të mundësojë pasqyrimin në mënyrë efikase dhe efektive me saktësi të të dhënave të nevojshme për personelin ushtarak aktiv, civil

dhe rezervë në MM/FSK. Krijimi i fushave me përmbajtjen e të dhënave të detajuara mbi personelin e MM/FSK do të mundësojnë mbështetjen në procesin e zhvillimit të karrierës, kushteve të shërbimit, pensionimit si dhe riintegrit të pjesëtarëve të MM/FSK.

1.4. Zgjerimi i kapaciteteve infrastrukturore dhe vazhdimi i blerjes së pajisjeve
Infrastruktura-Në vitin 2020 të zhvillimit të FSK-së, do të synojmë të rrisim kapacitetet hapësinore të njësive të FSK-së për akomodim. Meqë Komanda e Doktrinë dhe Stërvitjes (KDS) është prioriteti i parë për ngritje atëherë në këtë Komandë do të bëhet edhe ristrukturimi i objekteve infrastrukturore. Klasat e mësimi në trajnim bazik do të përshtaten për 40 deri 50 rekrut në një klasë mësimi, kurse për trajnime tjera specialistike të jenë 20-30 kadetë bazuar në infrastrukturën aktuale të KDS-së dhe projekteve të reja të infrastrukturës. Projekte infrastrukturore me rendësi gjatë vitit 2020 do të jenë: Ndërtimi i kuzhinës në kazermën e FSK-së -Istog, Renovimi i objektit të akomodimit-Regj.-I-Gjilan. Vazhdimi i ndërtimit të objekteve të Qendrës Regjionale të Trajnimit-Pomazatin, etj.

**Projektet tjera të planifikuara infrastrukturore për periudhën përkatëse janë të pasqyruara në Shtojcën D- Planin pesëvjeçarë të Logjistikës 2019-2023;*

Pajisjet-Pas përmbylljes së procesit të ristrukturimit të burimeve ekzistuese materiale të trashëguara nga FSK, bazuar në planin paraprak të prokurimit do të vazhdojë procesi i blerjeve të pajisjeve individuale, kolektive dhe specialistike të reja në përputhje me misionin, detyrat dhe përgjegjësitë e reja të njësive të FSK-së. Pajisjet të jenë moderne, sipas standardeve, të përshtatshme dhe të ndërvepruese me forcat partnere të NATO-s. Ato, sikur edhe sistemi i automjeteve taktike e jotaktike do të kenë specifikat funksionale dhe teknike të përshtatshme me natyrën e misionit dhe detyrave të njësive të FSK-së me pakon e instruksioneve të mirëmbajtjes permanente dhe pakon e trajnimeve specialistike për shfrytëzuesit tanë të drejtpërdrejtë.

Synimi tjetër në vitin 2020 është që të gjithë pjesëtarët e FSK-së të posedojnë shtretër fushor dhe thasë për fjetje me qëllim që në rast alarmimi ose ushtrimi, kur kërkohet që të gjithë pjesëtarët të jenë në gjendje gatishmërie të shfrytëzohen hallat e sporteve në kazermat e FSK si dhe objektet shtetërore në afërsi të kazermave ose vend incidenteve.

Pajisjet e planifikuara për blerje për periudhën përkatëse janë të pasqyruara në Shtojcën D- Planin pesëvjeçarë të Logjistikës 2019-2023;;

1.5. Pjesëmarrja aktive dhe kontributi substancial i FSK-së në ushtrimet, organizatat, iniciativat rajonale si dhe në ndërtimin e stabilitetit dhe bashkëpunimit rajonal

Synimet tona për vitin 2020 është angazhimi i MM dhe SHPFSK për të kontribuar në realizimin e programeve relevante të strukturave euroatlantike dhe të iniciativave rajonale siç është anëtarësimi në Kartën e Adriatikut-A5. Gjithashtu do të ofrohet kontributi ynë i rëndësishëm me qëllim të faktorizimit të FSK-së në Qendrën e bashkëpunimit për Siguri- RACVIAC në bazë të kërkesave dhe zhvillimeve në këtë organizëm. Gjatë vitit 2020 do të synohet dhe do të ketë angazhim të fuqishëm për organizimin e së paku dy ushtrimeve fushore në bashkëpunim me EUCOM dhe partneret rajonal si dhe konferencave apo seminareve me karakter rajonal e ndërkombëtar në Republikën e Kosovës. Gatishmëria për realizimin e ushtrimeve ndërkombëtare është dëshmuar paraprakisht edhe zyrtarisht, në bazë të letrës së KOMFSK-së drejtuar Komandantit të MARFOR (United States Marine Corps Forces Europe) për realizimin e një ushtrimi në këtë periudhë në Kosovë, dhe në koordinim me partnerët rajonal synohet që të organizohen edhe ushtrime tjera në të ardhmen.

1.6. Pjesëmarrja aktive dhe kontributi substancial në vendosjen e marrëdhënieve formale të partneritetit të Republikës së Kosovës me NATO-n dhe BE-n

Gjatë vitit 2020, MM dhe SHPFSK do të angazhohen maksimalisht për vendosjen e marrëdhënieve formale të partneritetit të Republikës së Kosovës me NATO-n dhe BE-n në fushën e mbrojtjes. Në këtë drejtim planifikohet që:

- Të sigurohet mbështetja e vazhdueshme e NATO-s për zhvillimin e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcës së Sigurisë të Kosovës;
- Të vazhdohet me dërgimin e oficerëve të FSK-së dhe personelit civil në shkollat e NATO-s dhe në qendrat e ekselencës së NATO-s çdo vit;
- Të hartohet Strategjia për anëtarësim në PfP dhe integrim në strukturat rajonale nga Ministria e Mbrojtjes dhe Ministrinë e Punëve të Jashtme mbi bazën e së cilës institucionet e Republikës së Kosovës, Ministria e Mbrojtjes dhe FSK-ja të fillojnë plotësimin e standardeve, kushteve dhe kriteret e kërkuara për anëtarësim në këtë program (PfP);
- Të fillojë procesi i anëtarësimit në PfP dhe organizata tjera regjionale të sigurisë (A5);
- Të punohet në krijimin e mundësisë së dërgimit të oficerëve të FSK-së në shtabet e planifikimit për operacione ndërkombëtare të udhëhequra nga NATO;
- Krijimi i kapaciteteve dhe aftësive të para për pjesëmarrje aktive në operacionet e reagimit në kriza jashtë vendit nën mbikëqyrjen e organizatave dhe aleancave ndërkombëtare. Për më tepër ky është një aktivitet shumë i rëndësishëm në procesin e ndërtimit të vetëbesimit dhe masat e ndërtimit të sigurisë në nivel global dhe rajonal.

Prioritetet kyçe në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar do të jenë edhe marrëveshjet me ministritë e mbrojtjes së Çekisë, Suedisë, Norvegjisë, Austrisë dhe Zvicrës si dhe zgjerimi i bashkëpunimit me vendet tjera.

Bashkëpunimi me vendet partnere do të mbetet kyç për FSK gjatë fazës së tranzicionit ngritjes së njësive. Aktivitetet e përbashkëta në kuadër të ODC-së do të merren me prioritet. Udhëheqësit dhe komandantët të përfshihen në planifikimin, bashkërendimin dhe zbatimin e të gjitha aktiviteteve që do të zhvillohen së bashku me NALT, DGMT, KFOR-in etj.

Gjithashtu, gjatë vitit 2020, do të implementohen detyrat e planifikuara paraprakisht dhe do të vazhdojë hartimi i planeve të veprimit për bashkëpunim ndërkombëtar, me qëllim të zhvillimit të kapaciteteve operacionale të njësive për pjesëmarrje në operacione, stërvitje të përbashkëta brenda dhe jashtë vendit me vendet e rajonit, vende anëtare ose partnere të NATO-së. Bashkëpunimi në fushën e mbrojtjes me NATO-n, BE-n, SEDM-in, A5, si dhe me nisma të tjera, do të fokusohet në programe të përbashkëta të fushës konceptuale, doktrinare dhe strategjike.

VITI 2020

SHTABI I PËRGJITHSHËM I FORCËS SË SIGURISË TË KOSOVËS – SHPFSK

2.1. Mirëmbajtja e kapaciteteve dhe aftësive ekzistuese për MUAC

Krahas angazhimeve në funksionalizimin e komponentëve shtabore, mirëmbajtjen e komandim-kontrollit në të gjitha hallkat e zingjirit komandues, ngritjen e operacionalitetit të njësive të riorganizuara pranshtabore dhe atyre kryesore, SHPFSK në fokus të vazhdueshëm do të ketë mirëmbajtjen në nivelin e duhur të kapaciteteve dhe aftësive operacionale të RMC-së dhe BXH-së për mbështetje të autoriteteve civile në gatishmëri të plotë.

2.2. Sistemi i Inteligjencës ushtarake i nivelit operativ dhe taktik

Strukturat e inteligjencës ushtarake operative dhe ajo taktike do të ristrukturohet, avancohet dhe zhvillohet në kuadër të SHPFSK, brigadave, regjimenteve dhe batalioneve të FSK.

Në vitin 2020 do të fillohet me rekrutimin e njësisë së rikonicionit (zbulimit) për mbështetje të operacioneve në bazë të misionit të FSK brenda dhe jashtë vendit.

Gjatë kësaj periudhës kohore, ndër të tjera, komponenti i Inteligjencës dhe Sigurisë, gjithashtu do të fokusohet në trajnimin, avancimin, operacionalizimin në të gjitha nivelet për të qenë koherent me standardet më të avancuara profesionale.

VITI 2020

KOMANDA E DOKTRINËS DHE STËRVITJES - KDS

2.3. Procesi i trajnimit për personelin e FSK-së

Pas procesit të riorganizimit të KDS-së, kompletimit të doktrinëve, manualeve, trajnimit të instruktorëve, rishikimit të plan-programeve trajnuese dhe ngritjes së infrastrukturës së nevojshme, ekipet e instruktorëve të KDS-së të mbështetur edhe nga ana e ekspertëve/partnerëve ndërkombëtarë do të fillojnë ciklin e trajnimeve. Gjatë trajnimit bazik, rekrutët e rinj marrin njohuritë primare ushtarake. Pastaj, ata zhvillohen më tej nëpër trajnimet specialistike të njësive ku shërbejnë, përmes zhvillimit të moduleve specifike për gjinitë ushtarake dhe destinohen në përmbushjen e misionit të njësive ku shërbejnë dhe trajnimeve individuale për mision të mbështetjes ushtarake për autoritete civile dhe trajnimeve individuale për këmbësori me qëllim të mbështetjes për zhvillimin e aftësive të FSK-së. Këto trajnime specialistike do të zhvillohen sipas planit të trajnimeve gjatë gjithë periudhës kohore 2019-2028.

**Plani i trajnimeve për periudhën afatmesme 2019-2023 është pasqyruar në Shtojcën D.*

Lista e trajnimeve (moduleve) specialistike të QSS/KDS në FSK

TRAJNIMI	KODI	AKTIVITETI TRAJNUES
MODULET (MOS) QENDRA E STËRVITJES SPECIALISTIKE	MODULI I	Kursi për trajnimin e instruktorëve (ITC) dhe grupeve të vogla ITC (SG ITC).
	MODULI S PËR XHENIO	Kursi për instruktorët e Inxhinierisë Luftarake
		Kursi për instruktorët e urave
		Kursi për instruktorët e pastrimit të rrugëve (e minuara)
		Kursi për instruktorët e fortifikimit
		Kursi për Instruktorët e ndërtimit vertikal
	MODULI S PËR LOG	Kursi i logjistikës.
		Kursi i mirëmbajtjes dhe transportit
		Kursi për qëndrueshmërinë fushore.
		Kursi për mirëmbajtjen fushore.
	MODULI S PËR CIS	Kursi për komunikim
		ECDL - International Computer Driving Licence
	MODULI S PËR RMC	Kursi për kërkim-shpëtim në dimër dhe male
		Kursi për EOD
		Kursi për K-9
		Kursi për kërkim-shpëtim në ujë .
		Kursi për MABK
	MODULI S PËR VOZITJE	Kursi për shofer të kat.B.
		Kursi për shofer të kat.C.
		Kursi për shofer të kat.D.
	MODULI S PËR KËMBESORI	Kursi i këmbësorisë
		Kursi për snajperist
		Kursi për armë automatike skuadre

		Kursi për granatahedhës
	MODULI S PËR ANTIBLIND	Kursi për TTP për antiblind dhe betejave në afërsi
		Kursi për raketa antitank (ATGM)
	MODULI S PËR MORTAJA	Kursi për drejtimin e zjarrit
		Kursi për Howitzer 105 mm
		Kursi për mortaja 60 mm dhe 81 mm
	MODULI S PËR MJEKËSI	Kursi për mjekësi preventive.
		Kursi për infermier ushtarak
		Kursi për mjekësi fushore.
	MODULI S PËR PU	Kursi për mbrojtje të afërt i PU-së
		Kursi për operacione të PU-së
		Kursi për PT
	MODULI S PËR GJUHE	Kursi i gjuhës angleze.
		Kursi i gjuhës turke
		Kursi i gjuhës gjermane
		Kursi i gjuhës shqipe.

Sqarim: Me ngjyrë të gjelbër-kurset ekzistuese, me ngjyrë. të verdhë-kurset që do të rishikohen dhe me ngjyrë të kuqe-kurset e reja që duhet të zhvillohen.

Duke pasur parasysh se objektivi kryesor në këtë periudhë është fillimi i krijimit të kapaciteteve dhe aftësive të para të këmbësorisë është zhvilluar edhe plani i kapaciteteve trajnuese dhe zhvillimit të trajnimeve që konsistojnë në:

- Ngritjen e kapaciteteve të reja në trajnime individuale dhe kolektive për kompletimin e kuadrit të specializuar në Qendrat e Trajnimit (QTB, QTK, QTS);
- Hartimin e Procedurave Standarde Operative që lidhen me fushën e operacioneve dhe trajnimeve që dalin nga dokumentet e nivelit strategjik;
- Zhvillimin e programeve të reja trajnuese që lidhen me deklaratën e misionit të njësive të FSK-së të shprehura dhe të listuar në analizën e RSSS-së;
- Trajnimin për Specialitete (Logjistikë, Komunikim, Policisë Ushtarake etj.);
- Ekipin për trajnime ushtarake (Military Training Team-MTT) për kapiten dhe major si version i shkurtuar i Kolegjit të Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm (Command and General Staff College-CGSC) dhe Kursi i Kapitenëve të Karrierës (Captains Career Course-CCC);
- Trajnimin për lider luftarak;
- Trajnimin për nënoficer shtabor;
- Konsolidimi dhe përmirësimi i Qendrës së Trajnimit Bazik dhe Specialistik për kualifikimin e ushtarëve, nënoficerëve dhe oficerëve për të përmbushur detyrat funksionale sipas specialiteteve përkatëse;
- Funksionalizimin e kapaciteteve të Qendrës për Trajnime Kolektive për zhvillimin, kontrollimin e trajnimeve dhe mirëmbajtjen e mbështetjes ekzistuese të trajnimeve deri në nivelin e një kompanie të përforcuar;
- Fillimin e ciklit të aftësimit të instruktorëve sipas degëve dhe gjinive ushtarake (këmbësori, MKAB, artileri, xhenio etj.);
- Përgatitja e instruktorëve për zhvillimin e trajnimeve në nivel Togu dhe Kompanie);

VITI 2020
KOMANDA E LOGJISTIKËS-KL

2.4. Vazhdimi i shtimit të kapaciteteve dhe aftësive të mbështetjes logjistike

Në të gjitha njësitet dhe nivelet e Komandës së Logjistikës do të vazhdojë shtimi i kapaciteteve dhe aftësive të mbështetjes logjistike (furnizim, transport, mirëmbajtje, shërbime të përgjithshme) për përmbushjen e detyrave dhe realizimin e operacioneve të njësive të FSK-së.

2.5. Rezervat ushtarake

FSK nga viti 2020 do fillojë edhe grumbullimin e stoqeve (rezervave) për 20 ditë operacion me mision të ri. Bazuar në rekomandimet që kanë dalë nga RSSS, rezervat janë përlogaritur në të gjitha kategoritë përbërëse si në ushqim, uniforma, armatim, municione, pajisje, pjesë rezervë, shërbim mirëmbajtjeje dhe servisim ndaj shkallës së qëndrueshmërisë së forcave në operacion në aspektin kohor dhe logjistik operacional.

VITI 2020
KOMANDA E FORCAVE TOKËSORE- KFT

2.6. Tranzicioni i BRSH-së në KFT dhe BAT-I/BRSH-së në REGJ. I-rë të Këmbësores

Pas vlerësimit të aftësive të BRSH-së do të fillojë procesi i tranzicioni i BRSH-së në KFT dhe BAT-I/BRSH-së në REGJ-I të Këmbësores me formësimin e strukturës trajnuese për të ardhmen me qëllim fillimin e ngritjes së kapaciteteve të para të këmbësores në vitin 2020. Krahas angazhimit në tranzicionin Bat. I të RSH-së në Regjimentin e I të Këmbësores do të mirëmbahen në mënyrë permanente kapacitetet dhe aftësitë ekzistuese në Bat.2 dhe Bat.3 të KFT-së.

VII-OBJEKTIVAT DHE AFTËSITË KRYESORE VJETORE TË SYNUARA NË VITIN 2021

OBJEKTIVAT VJETORE PËR VITIN 2021

1. Hartimi dhe funksionalizimi i politikave, legjislacionit, strategjive, doktrineve, procedurave dhe plan-programeve;
2. Përgatitja e kuadrove në mekanizmat ndërlidhës dhe për përfaqësim direkt në NATO;
3. Mirëmbajtja permanente e kapaciteteve, aftësive dhe gatishmërisë së plotë operacionale në MUAC;
4. Rritja e kapaciteteve të burimeve njerëzore, materiale dhe infrastrukturore dhe fuqizimi i transparencës, besueshmërisë dhe llogaridhënies;
5. Vazhdimi i implementimit të procesit të tranzicionit të njësive të FSK-s sipas PGJT-së;
6. Vazhdimi i procesit të trajnimit dhe arsimimit në përmbushjen e misionit të ri;
7. Zgjerimi i kapaciteteve dhe aftësive në mbështetje operacionale;
8. Krijimi i kapaciteteve dhe aftësive të para të këmbësores si dhe arritja e Aftësive Fillestare Operacionale (AFO/IOC);
9. Arritja e kapaciteteve dhe aftësive për të kontribuar në operacione ndërkombëtare humanitare;

AFTËSITË KRYESORE QË SYNOHET TË ARRIHEN NË VITIN 2021

MINISTRIA E MBROJTJES

- Realizimi i procesit përfundimtar të hartimit të akteve të reja ligjore dhe nënligjore;
- Realizimi i procesit përfundimtar të hartimit të dokumenteve të reja doktrinare, udhëzuese dhe procedurale;
- Ngritja e kapaciteteve të duhura për reagim të përbashkët në kriza jashtë vendit, brenda kornizës së operacioneve të udhëhequra nga NATO-ja apo BE-ja;
- Përgatitja e stafit të FSK-së për të qenë pjesë e Zyrës ndërlidhëse të Republikës së Kosovës me NATO-në fillimisht në Ambasadën e Rep. së Kosovës në Bruksel dhe në të ardhmen për përfaqësimin direkt në strukturat e NATO-së;
- Analiza e Procesit të Tranzicionit në fund të fazës- I-rë 2019-2021 si dhe rekomandimet për fazën II-të 2022-2024
- Vazhdimi i blerjeve të pajisjeve individuale dhe kolektive sipas FOCIS-it;
- Vazhdimi i procesit të rekrutimit;

SHTABI I PERGJITHSHEM I FORCËS SË SIGURISË KOSOVËS

- Mirëmbajtja permanente e kapaciteteve, aftësive dhe gatishmërisë së plotë operacionale për përgjigje në mbështetje ushtarake të autoriteteve civile;
- Krijimi i aftësive të para për misionin e ri të mbrojtjes së sovranitetit dhe integritetit territorial të Republikës së Kosovës dhe MUAC;
- Realizimi i projekteve të infrastrukturës (objekt banimi) dhe tri poligoneve për trajnime taktike me armë zjarri deri në nivel kompanie (T2 dhe T3) dhe një poligoni për stërvitje të njësive MKABK, KSH dhe EOD;

KOMANDA E FORCAVE TOKËSORE

- Realizimi i procesit të tranzicionit të Batalionit të dytë të Reagimit të Shpejtë në Regjimentit të Dytë të Këmbësisë.

KOMANDA E DOKTRINËS DHE STËRVITJES

- Ndërtimi i aftësive të para trajnuese individuale, specialistike dhe trajnimeve simulative deri në nivel të kompanisë;
- Krijimi i Qendrës për Mësime të mësuara;
- Ndërtimi i aftësive për vlerësim dhe vëzhgim deri në nivel të kompanisë;
- Realizimi i fazës përfundimtare të shkrimit të doktrineve, manualeve dhe PSO-ve për fushën e misionit të Mbrojtjes së sovranitetit dhe integritetit territorial të Republikës së Kosovës;
- Realizimi i trajnimeve të këmbësisë për nivel të skuadrës;
- Zhvillimi i instruktorëve për qitje me zjarr direkt të kalibrit mbi 5.56mm, p.sh. (snajper 50 kab, granatahdhës 40mm, raketahdhës 76mm dhe mitraloz 7.62mm)
- Realizimi i trajnimeve të kompanive të këmbësisë në nivel të regjimenteve;
- Realizimi i trajnimeve të kompanive mbështetëse të integruara me trajnimin e këmbësisë;

- Realizimi i testimit të TTP-ve në nivel të kompanive gjatë procesit të trajnimit.

KOMANDA E LOGJISTIKES

- Kompletimi i kapaciteteve teknike dhe aftësive profesionale për përmbushjen e nivelit III të mirëmbajtjes në Njësinë Qendrore të Mirëmbajtjes dhe nivelin IV në bashkëpunim me operatorët e jashtëm të kontraktuar ekonomik;
- Realizimi i nivelit të shërbimeve mjekësore në kuadër të poliklinikës mjekësore që përfshin: shërbimet e urgjencës, ekzaminimet mjekësore, shërbimet diagnostike (laborator, imazheri);
- Realizimi i nivelit të të mbështetjes mjekësore me kapacitetet në personel, pajisje dhe mjete teknike medicinale si në kushte paqeje ashtu dhe në kushte krize.

PRIORITETET KRYESORE NË FUNKSION TË REALIZIMIT TË OBJEKTIVAVE AFATMESME NË VITIN 2021

1. MINISTRIA E MBROJTJES

1.1. Vazhdimi i procesit përfundimtar të hartimit të akteve ligjore dhe nënligjore

Gjatë vitit 2021 planifikohet të përfundojë procesi i hartimit të akteve ligjore dhe nënligjore të reja si produkte juridike dhe kështu të kompletohet pakaja e akteve normative në funksion të legjitimitetit të të gjitha veprimeve në kuadër të fushave të misionit kushtetues të MM dhe FSK.

1.2. Vazhdimi i procesit përfundimtar të hartimit të dokumenteve doktrinare, udhëzuese dhe procedurale

Gjatë vitit 2021 planifikohet të përfundojë procesi i hartimit të dokumenteve doktrinare, udhëzuese dhe procedurale të reja si produkte të referuara në Doktrinën e Përgjithshme Ushtarake; Strategjinë e Mbrojtjes dhe Strategjitë dhe doktrinat e fushave funksionale gjithnjë në trend me standardet bashkëkohore të vendeve partnere dhe ato të përbashkëta të NATO-s.

1.3. Vazhdimi i procesit të rekrutimit

Procesi i rekrutimit do të jetë proces permanent, pra edhe në këtë periudhë do të zhvillohet në përputhje me procedurat, standardet dhe kriteret për rekrutim si dhe në përputhje me planin paraprak të rekrutimit.

(Shih Shtojcën C- Planin e rekrutimit 2019-2023)

1.4. Ndërtimi i objekteve të reja të akomodimit dhe poligoneve për trajnime taktike

Krahas rritjes së kapaciteteve njerëzore shtohet edhe nevoja për zgjerim të hapësirave për punë, studim, jetë dhe akomodim. Nisur nga kjo, në kuadër të planit të infrastrukturës në kazernat aktuale në Gjilan dhe Mitrovicë do të ngriten edhe nga një objekt banimi duke filluar në vitin 2021. Gjatë vitit 2021 do të fillojë ndërtimi i tri poligoneve për trajnime taktike me armë zjarri deri në nivel kompanie (T2 dhe T3) dhe një poligoni për stërvitje të njësive MKABK, KSH dhe EOD.

1.5. Vazhdimi i procesit integruar në mekanizmat ndërkombëtarë të mbrojtjes dhe sigurisë
Vazhdimi i procesit të Integrimi në Programin për Partneritet për Paqe (PfP) dhe thellimi i bashkëpunimit dypalësh dhe rajonal në fushën e mbrojtjes do të jenë ndër prioritet kyçe gjatë vitit 2021.

Në vitin 2021 angazhimi kryesor të jetë i orientuar në ngritjen graduale të kontributit të FSK-së për reagim të përbashkët në kriza jashtë vendit, në radhë të parë brenda kornizës së operacioneve të udhëhequra nga NATO apo BE. Gjithashtu planifikohet të fillojë përgatitja e stafit të FSK-së për të qenë pjesë e Zyrës Ndërlidhëse të Republikës së Kosovës me NATO-n, së pari me Ambasadën e Republikës së Kosovës në Bruksel dhe në të ardhmen për përfaqësimin e drejtpërdrejtë në strukturat e NATO-s.

1.6. Vazhdimi i realizimit të projekteve infrastrukturore si dhe blerjeve të sistemeve dhe pajisjeve individuale dhe kolektive sipas FOCIS

Edhe gjatë kësaj periudhe do të vazhdojë realizimi i projekteve të planifikuara infrastrukturore. Gjithashtu do të vazhdojë procesi i blerjes së sistemeve dhe pajisjeve individuale dhe kolektive sipas Programit FOCIS.

(Shih Shtojca F-Plani i projekteve infrastrukturore, sistemeve, pajisjeve dhe armatimit.)

2. SHATABI I PËRGJITHSHËM I FSK-së

2.1. Mirëmbajtja e kapaciteteve, aftësive dhe gatishmërisë së plotë operacionale për MUAC
Krahas këtij procesi, SHPFASK do të jetë në vazhdimësi e angazhuar të mirëmbajë kapacitetet, aftësitë dhe gatishmërinë e plotë operacionale për përgjigje në mbështetje ushtarake të autoriteteve civile. Krahas mirëmbajtjes së këtyre aftësive qasja në drejtim të krijimit të aftësive për misionin e ri (MT) nënkupton vazhdimin e krijimit të kapaciteteve të mbështetjes qendrore.

KOMANDA E FORCAVE TOKËSORE

2.2. Tranzicioni i BAT-2RSH-së në REGJ-2 të Këmbësoresë

Në vitin 2021, fokusi qendror i SHPFASK-së në koordinim me nivelin strategjik ministror dhe atë implementues, pra Komandën e Forcave Tokësore, pas krijimit të Regjimentit të Parë të Këmbësoresë do të jetë vazhdimi i tranzicionit të batalionit të radhës (sipas Kursit të Veprimit të shkallëzuar), pra Batalionit të Dytë të Reagimit të Shpejtë në Regjimentit të Dytë të Këmbësoresë.

KOMANDA E DOKTRINËS DHE STËRVITJES-KDS

2.3. Vazhdimi i ngritjes së kapaciteteve trajnuese për këmbësori

Në funksion të krijimit të kapaciteteve dhe aftësive të para operacionale (IOC) në misionin e mbrojtjes së territorit, pra kapacitetet e para të këmbësoresë me dy regjimente e para deri në këtë periudhë kohore, në kuadër të procesit për zhvillimit doktrinar dhe trajnues SHPFASK me KDS-në do të zhvillojnë këto aktivitete:

- Ndërtimi i aftësive trajnuese individuale, specialistike dhe trajnimeve simulative deri në nivel të kompanisë;
- Krijimi i Qendrës për Mësime të Mësuar;
- Ndërtimi i aftësive për vlerësim dhe vëzhgim deri në nivel të kompanisë;

- Faza përfundimtare e shkrimit të doktrinae, manualeve dhe PSO-ve për fushën e misionit të mbrojtjes së territorit;
- Zhvillimi i trajnimit të këmbësorisë në nivel të skuadrës;
- Zhvillimi i instruktorëve për qitje me zjarr direkt të kalibrit mbi 5.56mm, p.sh (snajper 50 kab, granatahdhës 40mm, raketahdhës 76mm dhe mitraloz 7.62mm);
- Trajnimi i kompanive të këmbësorisë në nivel të regjimenteve;
- Trajnimi i kompanive mbështetëse të integruar me trajnimin e këmbësorisë;
- Testimi i TTP-ve në nivel të kompanive gjatë procesit të trajnimit;
- Vazhdimi i trajnimit të nënoficerëve.

KOMANDA E LOGJISTIKËS-KL

2.4. Vazhdimi i shtimit të kapaciteteve dhe aftësive të mbështetjes logjistike

Në të gjitha njësitet dhe nivelet e Komandës së Logjistikës do të vazhdojë shtimi i kapaciteteve dhe aftësive të mbështetjes logjistike (furnizim, transport, mirëmbajtje, shërbime të përgjithshme) për përmbushjen e detyrave dhe realizimin e operacioneve të njësive të FSK-së.

2.5. Ngritja, zhvillimi dhe funksionalizimi i Poliklinikës Mjekësore

Në vitin 2021 në faza do të bëhet ngritja, zhvillimi dhe funksionalizimi i Poliklinikës Mjekësore. Blerja e pajisjeve dhe plotësimi i personelit do të bëhet konform TOP-it dhe nivelit të gatishmërisë. Gjatë periudhës afatmesme do të organizohen trajnime dhe stërvitje specialistike, si brenda ashtu edhe jashtë vendit, me qëllim të mbajtjes, ngritjes, zhvillimit dhe profesionalizimit të kapaciteteve të mjekësisë për mbështetje të njësive të FSK-së në operacione brenda dhe jashtë vendit si dhe do të zhvillohet mirëmbajtja e pajisjeve mjekësore. Bazuar në PAZH dhe Planin Mbështetës të Mjekësisë në këtë periudhë synohet aktivizimi i shërbimeve mjekësore në kuadër të poliklinikës që përfshin: shërbimet e urgjencës, ekzaminimet mjekësore, shërbimet diagnostike (laborator, imazheri). Në përputhje me misionin e ri të FSK-së, detyrat dhe përgjegjësitë e reja të njësive dhe nevojat për funksionalizimin e fushave të planifikuara të mjekësisë do të bëhet kompletimi me personel të specializuar për fushat e caktuara mjekësore si dhe pajisje e materiale të nevojshme për realizimin e detyrave dhe përgjegjësi sipas planit të rekrutimit të komponentit mjekësor (mjek, infermier dhe paramedik) me përgatitje adekuate arsimore dhe profesionale. Gjithashtu vlerësohet funksionalizimi i mbështetjes mjekësore me kapacitetet në personel, pajisje dhe mjete teknike medicinale si në kushte paqeje ashtu dhe në kushte krize.

VI. Planifikimi i buxhetit të mbrojtjes për periudhën afatmesme 2019-2023

Planifikimi financiar afatmesëm 2021 do të zhvillohet në Kornizën Afatmesme Trevjeçare të Shpenzimeve (A+3). Njëherësh përveç kësaj, Qeveria e Republikës së Kosovës është pajtuar në parim me Planin tonë buxhetor afatgjatë 2019-2028 që nënkupton edhe përmbushjen e rekomandimeve të RSSH-se nga Analiza e miratuar nga vet lideshipi i Qeverisë së Kosovës. Realizimi i pakos së detyrave ekzistuese për misionin aktual dhe procesit të ngritjes së kapaciteteve të reja në përputhje me misionin e ri të FSK-së, e obligon Qeverinë e Republikës së Kosovës për buxhet shtesë për çdo vit, gjatë periudhës 10 vjeçare.

Për ilustrim, planifikimi financiar 2019-2023 ka për synim mbështetjen me burime financiare të MM/FSK me qëllim të arritjes së objektivave dhe prioriteteve të saj si në vijim:
Ndarja e burimeve financiare për Planifikim afatmesëm është pasqyruar në Tabelën 1.

Tabela 1. Plani i buxhetit të mbrojtjes sipas Qarkores buxhetore 2019-2023 bazuar në të dhënat e Departamentit të Transformimit.

Kategoritë Ekonomike	2019	2020	2021	2022	2023
Numri i Punëtorëve	3480	3636	3864	4264	4322
Paga dhe Mëditje	23,459,849.00	29,110,889.00	31,864,522.00	36,142,820.00	38,520,685.00
Mallra dhe Shërbime	12,081,245.00	12,571,245.00	13,192,345.00	13,400,000.00	19,500,000.00
Shpenzime Komunale	938,000.00	938,000.00	988,000.00	1,000,000.00	1,300,000.00
Shpenzime Kapitale	22,208,966.00	28,890,704.00	31,890,704.00	36,220,000.00	36,246,556.00
Totali	58,688,060.00	71,510,838.00	77,935,571.00	86,762,820.00	95,567,241.00

VIII. OBJEKTIVAT DHE AFTËSITË KRYESORE TË SYNUARA PËR VITIN 2022

MINISTRIA E MBROJTJES

1.1. Rishikimi dhe hartimi sipas nevojës të akteve ligjore dhe nënligjore

Gjatë vitit 2022 planifikohet që të rishikohen dhe hartohen aktet ligjore dhe nënligjore të reja si produkte juridike dhe kështu të mundësohet përditësimi sipas zhvillimeve të kohës me qëllim që aktet normative në funksion të jenë në harmoni me të gjitha aktet ligjore në nivel vendi dhe të harmonizohen me dokumentet strategjike të NATO-së.

1.2. Vazhdimi i procesit të hartimit dhe rishikimit të vazhdueshëm me qëllim përditësimin e dokumenteve doktrinare, udhëzuese dhe procedurale

Gjatë vitit 2022 planifikohet të implementohen dokumentet doktrinare, udhëzuese dhe procedurale të reja gjithnjë në trend me standardet bashkëkohore të vendeve partnere dhe ato të përbashkëta të NATO-s. Gjithashtu në vazhdimësi të përditësohen të gjitha dokumentet doktrinare dhe procedurale duke përdorur sistemin e mësimave të nxjerra.

1.3. Vazhdimi i procesit të rekrutimit

Procesi i rekrutimit do të jetë proces permanent, pra edhe në këtë periudhë do të zhvillohet në përputhje me procedurat, standardet dhe kriteret për rekrutim si dhe në përputhje me planin paraprak të rekrutimit. (Shih Shtojca C- Plani i rekrutimit 2019-2023).

1.4. Ndërtimi i objekteve të reja të akomodimit dhe poligoneve për trajnime taktike

Krahas rritjes së kapaciteteve njerëzore shtohet edhe nevoja për zgjerim të hapësirave për punë, studim, jetë dhe akomodim. Nisur nga kjo, në kuadër të planit të infrastrukturës në kazermat aktuale në Gjilan dhe Mitrovicë do të ngritën edhe nga një objekt banimi duke filluar në vitin 2022. Gjatë vitit 2022 do të fillojë ndërtimi i depove qendrore të artilerisë, të depove Klasa 1 dhe 2, vazhdon ndërtimi i tri poligoneve për trajnime taktike me armë zjarri deri në nivel kompanie (T2 dhe T3) dhe një poligoni për stërvitje të njësisë MKABK, KSH dhe EOD.

1.5. Vazhdimi i procesit integruar në mekanizmat ndërkombëtarë të mbrojtjes dhe sigurisë

Vazhdimi i procesit të integritetit në Programin për Partneritet për Paqe (PfP) dhe thellimi i bashkëpunimit dypalësh rajonal në fushën e mbrojtjes do të jetë ndër prioritetet kyçe dhe të vazhdueshme edhe gjatë vitit 2022.

Në vitin 2022 angazhimi kryesor të jetë i orientuar në mbajtjen e kontributit të FSK-së për reagim të përbashkët në kriza jashtë vendit, brenda kornizës së operacioneve të udhëhequra nga NATO apo BE.

1.6. Vazhdimi i realizimit të projekteve infrastrukturore si dhe blerjeve të sistemeve dhe pajisjeve individuale dhe kolektive sipas FOCIS

Edhe gjatë kësaj periudhe do të vazhdojë realizimi i projekteve të planifikuara infrastrukturore. Gjithashtu do të vazhdojë procesi i blerjes së sistemeve dhe pajisjeve individuale dhe kolektive sipas Programit FOCIS-Plani Gjithëpërfshirës i Tranzicionit.

(Shih Shtojcën F-Plani i projekteve infrastrukturore, sistemeve, pajisjeve dhe armatimit).

SHTABI I PËRGJITHSHËM I FORCËS SË SIGURISË SË KOSOVËS

2.1. Mirëmbajtja e kapaciteteve, aftësive dhe gatishmërisë së plotë operacionale për MUAC

Në aktivitetet kryesore gjatë kësaj periudhe do të jetë procesi i vlerësimit objektiv të nivelit të arritshmërisë së aftësive bazuar në sistemin **DOTMLPPF** (Doctrine, Organization, Training, Materiel, Leadership & Education, Personnel, Facilities and Policy).

Përveç tjerash do të vazhdojë të ofrohet mbajtja e vazhdueshme e kapaciteteve për MUAC si dhe përgatitjet për operacionet e mundshme ndërkombëtare bazuar në aftësitë e RMC-së dhe Bat. Xhenios.

Krahas detyrave të planifikuara për këtë periudhë kohore, do të zhvillohen edhe përgatitjet për kalim në fazën e III-të (2025-2028) të tranzicionit, duke vlerësuar dhe identifikuar nevojat për personel dhe kërkesat e hershme trajnuese për instruktorë, të cilat do të jenë qenësore për fillimin e fazës së tretë të zhvillimit të mundësive të KFT-së (me mbështetje luftarake dhe mbështetje luftarake me shërbime).

KOMANDA E FORCAVE TOKËSORE

2.2. Tranzicioni i BAT-3 RSH-së në REGJ-3 të Këmbësorisë

Në vitin 2022, fokusi qendror i SHPFSK-së në koordinim me nivelin strategjik ministror dhe atë implementues, pra Komandën e Forcave Tokësore, pas krijimit të Regjimentit të Parë dhe të Dytë të Këmbësorisë do të jetë vazhdimi i tranzicionit të batalionit të radhës (sipas Kursit të Veprimit të shkallëzuar), pra Batalionit të Tretë të Reagimit të Shpejtë në Regjimentit të Tretë të Këmbësorisë.

Në të njëjtën kohë do të mirëmbahen kapacitetet dhe aftësitë e arritura operacionale me qëllim të ofrimit të forcave të gatshme në përmbushje të misionit.

KOMANDA E DOKTRINËS DHE STËRVITJES-KDS

2.3. Vazhdimi i ngritjes së kapaciteteve trajnuese për këmbësori

Në funksion të krijimit të kapaciteteve dhe aftësive të para operacionale (IOC) në misionin e mbrojtjes së territorit, pra kapacitetet e para të këmbësorisë me dy regjimentet e para deri në këtë periudhë kohore, në kuadër të procesit për zhvillimit doktrinar dhe trajnues SHPFSK me KDS-në do të zhvillojnë këto aktivitete:

Programet dhe kurrikulat e arsimit dhe trajnimit të përgjithshëm e specialistik do të plotësojnë kërkesat për formimin e aftësive në nivel strategjik, operacional dhe taktik, si dhe cilësive të lidershit dhe performancës, të përcaktuara sipas niveleve përkatëse. Një pjesë e programeve të arsimit dhe trajnimit individual të oficerëve dhe nënoficerëve do të zhvillohen në gjuhën angleze.

- Ndërtimi dhe rritja e aftësive trajnuese individuale, specialistike dhe trajnimeve simulative deri në nivel të kompanisë;
- Krijimi dhe përdorimi i sistemit të mësimave të nxjerra nëpërmes Qendrës për Mësime të Nxjerra;
- Ndërtimi dhe mbajtja e aftësive për vlerësim dhe vëzhgim deri në nivel të kompanisë;
- Përfundimi i hartimit të doktrinave, manualeve, TTP për fushën e misionit të mbrojtjes së territorit, si dhe rishikimi dhe rifreskimi i vazhdueshëm i dokumenteve doktrinarë;
- Trajnimi i vazhdueshëm nëpërmjet ushtrive kolektive të kompanive të këmbësorisë në nivel të regjimenteve;
- Trajnimi i kompanive mbështetëse të integruara me trajnimin e këmbësorisë;
- Testimi i TTP-ve në nivel të kompanive gjatë procesit të trajnimit;
- Vazhdimi i trajnimit të nënoficerëve dhe oficerëve sipas specializimeve dhe konceptit të zhvillimit të karrierës.

KOMANDA E LOGJISTIKËS-KL

2.4. Vazhdimi i shtimit të kapaciteteve dhe aftësive të mbështetjes logjistike

Në Komandën e Logjistikës do të vazhdojë mbajtja e vazhdueshme dhe rritja e kapaciteteve dhe aftësive të mbështetjes logjistike (furnizim, transport, mirëmbajtje, shërbime të përgjithshme) për përmbushjen e detyrave dhe realizimin e operacioneve të njësive të FSK-së.

Bazuar në përcaktimin dhe kategorizimin e periudhave kohore të Planit Gjithëpërfshirës të Tranzicionit dhe të Planit Afatgjatë të Zhvillimit, gjatë vitit 2022 fokusi kryesor do të jetë në zhvillimin dhe modernizimin e mëtutjeshëm të kapaciteteve të komandës, kontrollit dhe komunikimit; vazhdimin e kompletimit të FSK-së me pajisje individuale dhe kolektive. Aftësitë operacionale do të vazhdojnë të përsosen gjithnjë e më shumë në funksion të përmbushjes së misionit për mbështetje ushtarake autoriteteve civile.

IX. OBJEKTIVAT DHE AFTËSITË KRYESORE TË SYNUARA PËR VITIN 2023

MINISTRIA E MBROJTJES

1.1. Rishikimi dhe hartimi sipas nevojës të akteve ligjore dhe nënligjore

Gjatë vitit 2022 planifikohet që të rishikohen dhe hartohen aktet ligjore dhe nënligjore të reja si produkte juridike dhe kështu të mundësohet përditësimi sipas zhvillimeve të kohës me qëllim që aktet normative në funksion të jenë në harmoni me të gjitha aktet ligjore në nivel vendi dhe të harmonizohen me dokumentet strategjike të NATO-së.

1.2. Vazhdimi i procesit të hartimit dhe rishikimit të vazhdueshëm me qëllim përditësimin e dokumenteve strategjike, doktrinarë dhe procedurale

Gjatë vitit 2023 planifikohet të implementohen dokumentet doktrinare, udhëzuese dhe procedurale të reja gjithnjë në trend me standardet bashkëkohore të vendeve partnere dhe ato të përbashkëta të NATO-s. Gjithashtu në vazhdimësi të përditësohen të gjitha dokumentet strategjike, doktrinare dhe procedurale

1.3. Vazhdimi i procesit të rekrutimit

Procesi i rekrutimit do të jetë proces permanent, pra edhe në këtë periudhë do të zhvillohet në përputhje me procedurat, standardet dhe kriteret për rekrutim si dhe në përputhje me planin paraprak të rekrutimit. *(Shih Shtojcën C- Plani i rekrutimit 2019-2023)*

1.4. Ndërtimi i objekteve të reja të akomodimit dhe poligoneve për trajnime taktike

Vazhdon rritja e kapaciteteve njerëzore shtohet edhe nevoja për zgjerim të hapësirave për punë, studim, jetë dhe akomodim. Nisur nga kjo, në kuadër të planit të infrastrukturës në kazermat aktuale në MM/FSK do të vazhdojë ndërtimi i objekteve për akomodim sipas planifikimit edhe gjatë vitit 2023. Gjatë vitit 2023 do të fillojë ndërtimi i poligonit për stërvitje taktike deri në nivel Batalioni; vazhdon ndërtimi i depove qendrore të artilerisë, të depove Klasa 1 dhe 2, vazhdon ndërtimi i tri poligoneve për trajnime taktike me armë zjarri deri në nivel kompanie (T2 dhe T3) dhe një poligoni për stërvitje të njësisë MKABK, KSH dhe EOD; po ashtu vazhdon ndërtimi i poligonit të kalitjes fizike.

1.5. Vazhdimi i procesit integruar në mekanizmat ndërkombëtarë të mbrojtjes dhe sigurisë

Vazhdimi i procesit të Integrimi në Programin e Partneritetit për Paqe (PfP) dhe thellimi i bashkëpunimit dypalësh rajonal në fushën e mbrojtjes do të jetë ndër prioritetet e vazhdueshme edhe gjatë vitit 2023.

Në vitin 2023 angazhimi kryesor të jetë i orientuar në pjesëmarrjen dhe mbajtjen e kontributit të FSK-së për reagim të përbashkët në kriza jashtë vendit, brenda kornizës së operacioneve të udhëhequra nga NATO apo BE.

1.6. Vazhdimi i realizimit të projekteve infrastrukturore si dhe blerjeve së sistemeve dhe pajisjeve individuale dhe kolektive sipas FOCIS

